VENDIM
Nr. 347, datë 29.12.2025

MBI MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI EMERGJENCËN DHE RIVENDOSJEN

Në mbështetje të neneve 16, 20, germat "a", 23, pika 1, germa "b", 30 pika 2 dhe 90, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3142 prot., datë 24.12.2025, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, "Mbi miratimin e 'Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen'",

konstatoi se:

- Shoqëria "OST" sh.a., me shkresën nr. 2903, datë 26.5.2025, të protokolluar pranë ERE me nr. 1739, datë 30.5.2025, ka paraqitur kërkesën për miratimin e "Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen" si akt transpozues i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2196, datë 24.11.2017, "Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen".

1. Fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së "OST" sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 292, datë 13.11.2025, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e "Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen".

- Draftakti i propozuar nga "OST" sh.a. përbën transpozim të drejtpërdrejtë të "Rregullores (BE) 2017/2196, 'Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen'", në përputhje me vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

2. Konsultimi publik dhe njoftimi i palëve

- ERE, me shkresën nr. 2159/2 prot., datë 17.11.2025, njoftoi palët e interesit, si më poshtë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., ALPEX sh.a., Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), si dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Vendimi nr. 292, datë 13.11.2025 "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së 'OST' sh.a. për miratimin e 'Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen'", është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 224, datë 3.12.2025, si dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, së bashku me draft "Kodin e Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen" në gjuhën shqipe dhe angleze, në rubrikën "Konsultime".

- Fillimi i procedurës në muajin nëntor 2025 i parapriu një faze analize paraprake juridike dhe teknike të kërkesës së paraqitur nga "OST" sh.a., në muajin maj 2025, e cila u konsiderua e domosdoshme për vlerësimin e përputhshmërisë së draftit me kuadrin ligjor kombëtar në proces ndryshimi, si dhe me detyrimet që rrjedhin nga kuadri i Komunitetit të Energjisë. Gjatë procesit të konsultimit publik nuk janë paraqitur komente apo përgjigje nga palët e interesit.

3. Vlerësime të ERE-s

- Në përputhje me nenin 4, të Rregullores (BE) 2017/2196, "OST" sh.a. është e detyruar të hartojë dhe t'i paraqesë për miratim autoritetit rregullator përkatës termat dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe të shërbimeve të rivendosjes, si dhe planin e testimit për zbatimin e këtyre shërbimeve, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e rregullores.

- Këto dokumente duhet të përmbajnë, ndër të tjera, karakteristikat përkatëse të shërbimit, mundësinë e agregimit dhe, për shërbimet e rivendosjes, hartëzimin e burimeve të energjisë së nevojshme për operimin në *black start* dhe në kushte të operimit të izoluar. Para miratimit të tyre, autoriteti rregullator, shqyrton propozimet e paraqitura nga OST për të garantuar përputhshmërinë me objektivat e rregullores "Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen", funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit, sigurinë e furnizimit dhe trajtimin e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në sistem, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

Duke marrë parasysh sfidat teknike dhe nevojën për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e emergjencave, propozohet që OST të raportojë periodikisht për përgatitjen e këtyre planeve dhe të depozitojë dokumentacionin për shqyrtim pranë ERE-s brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, sikurse përcaktuar në rregullore.

Në vijim të komenteve dhe sugjerimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të përcjella nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 24.7.2025, në kuadër të procesit të përgjithshëm të vlerësimit dhe përafrimit të kuadrit ligjor kombëtar me Paketën e Energjisë së Pastër, u vlerësua se këto sugjerime kanë rëndësi të veçantë për qasjen e ndjekur nga ERE në transpozimin e Kodit të Rrjetit dhe udhëzimeve të tregut, përfshirë dispozitat që lidhen me Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, metodologjitë e përbashkëta të hartuara nga operatorët dhe autoritetet rregullatore, çështjet me karakter ndërkufitar, si dhe qendrat rajonale të koordinimit për operimin e sistemeve elektroenergjetike.

-Për rrjedhojë, ERE do të vijojë të ushtrojë diskrecionin e saj publik në zbatimin dhe interpretimin e këtyre detyrimeve, duke vlerësuar rast pas rasti çdo vendimmarrje që lidhet me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të vendimeve të autoriteteve rregullatore kombëtare (NRAs), ACER-it dhe ECRB-së, në përputhje me legjislacionin sektorial kombëtar dhe detyrimet që rrjedhin nga kuadri i Komunitetit të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen" (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë "OST" sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KODI I RRJETIT MBI EMERGJENCËN DHE RIVENDOSJEN
(Rregullore e Komisionit (BE) 2017/2196, datë 24 nëntor 2017)

Inkorporuar dhe përshtatur me anë të vendimit të Këshillit Ministror D/2022/03/MC-EnC, më 15 dhjetor 2022, mbi inkorporimin e Rregullores (BE) 2019/942, Rregullores (BE) 2019/943,

Rregullores (BE) 2015/1222, Rregullores (BE) 2016/1719, Rregullores (BE) 2017/2195, Rregullores (BE) 2017/2196, Rregullores (BE) 2017/1485 në *acquis* të Komunitetit të Energjisë, mbi amendimin e shtojcës I, të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe mbi ndryshimet e vendimeve të Këshillit Ministror nr. 2021/13/MC-EnC dhe nr. 2011/02/MC-EnC.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Subjekt

Me qëllim ruajtjen e sigurisë operacionale, për të parandaluar përhapjen ose përkeqësimin e një incidenti për shmangien e një shqetësimi në shkallë të gjerë dhe gjendjes së *blackout*-it, si dhe për të lejuar rikthimin e shpejtë dhe efikas të sistemit elektroenergjetik nga gjendja e alarmit ose *blackout*-it, kjo rregullore krijon një kod rrjeti i cili përcakton kërkesat mbi:

a) menaxhimin nga OST-të të gjendjeve të *blackout*-it, emergjencës dhe rivendosjes;

b) koordinimin e operimit të sistemit në Komunitetin e Energjisë në gjendjet e *blackout*-it dhe emergjencës dhe rivendosjes;

c) simulimet dhe testimet për të garantuar rivendosjen e besueshme, eficiente dhe të shpejtë të sistemeve të transmetimit të ndërlidhura, në gjendjen normale nga gjendja e emergjencës ose *blackout*-it;

d) mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të garantuar një rivendosje të besueshme, efikase dhe të shpejtë në gjendjen normale nga gjendja e emergjencës ose e *blackout*-it të sistemeve të transmetimit të ndërlidhur.

Neni 2
Objekti

1. Kjo rregullore zbatohet për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit (SGU), ofruesit e shërbimeve të mbrojtjes, ofruesit e shërbimeve të rivendosjes, palët përgjegjëse të balancimit, ofruesit e shërbimeve të balancimit, operatorët e tregut të energjisë elektrike të nominuar (NEMO-t) dhe subjektet e tjera të caktuara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC dhe Rregulloren e Komisionit (BE) 2016/1719, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2022/03/MC-EnC.

2. Në veçanti, kjo rregullore zbatohet për SGU-të, si më poshtë:

a) modulet gjeneruese ekzistuese dhe të reja të energjisë, të klasifikuara si të tipit C dhe D, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 5 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC;

b) modulet gjeneruese ekzistuese dhe të reja të energjisë elektrike, të klasifikuara si tip B, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 5 të Rregullores (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, kur ato identifikohen si SGU në përputhje me nenin 11 (4) dhe nenin 23 (4);

c) objektet ekzistuese dhe të reja të kërkesës të lidhura në transmetim;

d) sistemet e mbyllura të shpërndarjes ekzistuese dhe të reja, të lidhura në transmetim;

e) ofruesit e ridispeçimit të moduleve gjeneruese të energjisë ose objektet e kërkesës me anë të agregimit dhe siguruesit e rezervës së fuqisë aktive, në përputhje me Titullin 8 të Rregullores (BE) 2017/1485 të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC; dhe

f) sistemet me rrymë të vazhduar me tension të lartë (HVDC) të reja dhe ekzistuese dhe modulet e parkut të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4(1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Grupit Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC.

3. Kjo rregullore zbatohet mbi modulet gjeneruese të energjisë të tipit A, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 5, të Rregullores (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, mbi modulet gjeneruese ekzistuese dhe të reja të energjisë të tipit B, përveç atyre të përmendur në paragrafin 2/“b”, si dhe mbi objektet ekzistuese dhe të reja të kërkesës, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe palët e treta që sigurojnë përgjigje të kërkesës, kur ato kualifikohen si ofrues të shërbimit të mbrojtjes ose ofrues të shërbimit të rivendosjes në përputhje me nenin 4 (4).

4. Tipat A dhe B, të moduleve gjeneruese të energjisë të përmendura në paragrafin 3, objektet e kërkesës dhe sistemet e mbyllura të shpërndarjes që sigurojnë përgjigje të kërkesës mund të përmbushin kërkesat e kësaj rregulloreje, direkt ose indirekt, nëpërmjet një pale të tretë, sipas kushteve të përcaktuara në përputhje me nenin 4 (4).

5. Kjo rregullore do të zbatohet mbi njësitë e depozitimit të SGU-ve, një ofruesi shërbimi të mbrojtjes ose një ofruesi të shërbimit të rivendosjes, i cili mund të përdoret për balancimin e sistemit, me kusht që ato të identifikohen si të tilla në planet e mbrojtjes së sistemit, planet e rivendosjes ose në kontratën përkatëse të shërbimit.

6. Kjo rregullore do të zbatohet në të gjithë sistemet e transmetimit, sistemet e shpërndarjes dhe interkoneksionet në palët kontraktuese dhe shtetet anëtare që i përkasin zonës sinkrone të Evropës Kontinentale, përfshirë qendrat rajonale të sigurisë, përveç sistemeve të transmetimit dhe sistemeve të shpërndarjes ose pjesëve të tyre të palëve kontraktuese, që nuk operojnë të sinkronizuara me zonën sinkrone të Evropës Kontinentale (EK).

7. Në palët kontraktuese ku ekziston më shumë së një operator i sistemit të transmetimit, kjo rregullore zbatohet për të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit brenda asaj pale kontraktuese. Kur një operator i sistemit të transmetimit nuk ka një funksion të rëndësishëm lidhur me një ose më shumë detyrime sipas kësaj rregulloreje, palët kontraktuese mund të parashikojnë që përgjegjësia për përmbushjen e këtyre detyrimeve t’u caktohet një ose më shumë operatorëve të ndryshëm specifik të sistemit të transmetimit.

8. <..>

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregulloreje, referohen përkufizimet e parashikuara në nenin 2 të Direktivës BE 2019/944/të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC; në nenin 2 të Rregullores (BE) nr. 2019/943, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC; në nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 543/2013, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2015/01/PHLG-EnC, në nenin 2 të Rregullores (BE) 2015/1222 e përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC; në nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e

Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC; në nenit 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC; në nenin 2 i Rregullores të Rregullores (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror nr. 2018/04/PHLG-EnC; në nenin 2 të Rregullores (BE) 2016/1719, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC dhe në nenit 2 të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Përveç tyre, do të zbatohen edhe përkufizimet, si më poshtë:

1. "Sigurues i shërbimit të mbrojtjes (*Defence Service Provider – DSP*)" është personi juridik me detyrimin ligjor ose kontraktual për të siguruar një shërbim që kontribuon në një ose disa masa të planit të mbrojtjes së sistemit;

2. "Siguruesi i shërbimit të rivendosjes (*Restoration Service Provider – RSP*)" është personi juridik me detyrimin ligjor ose kontraktual për të ofruar një shërbim që kontribuon në një ose disa masa të planit të rivendosjes;

3. "Përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit me prioritet të lartë (*High Priority Significant Grid User – HP-SGU*)" është përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit për të cilin zbatohen kushte të veçanta për shkyçjen dhe rienergjizimin;

4. "Kërkesë e netuar (*Netted Demand – ND*)" nënkupton vlerën neto të fuqisë aktive të vëzhguar nga një pikë e caktuar e sistemit, e llogaritur si (ngarkesë-gjenerim), e shprehur përgjithësisht në kilovat (kw) ose megavat (mw), në një çast të dhënë ose e mesatarizuar mbi çdo interval të caktuar kohe;

5. "Plani i rivendosjes (*Restoration Plan – RP*)" nënkupton të gjitha masat teknike dhe organizative të nevojshme për rivendosjen e sistemit në gjendjen normale;

6. "Rienergjizim (*Re-energisation – RE*)" nënkupton rilidhjen e gjenerimit dhe kërkesës për të energjizuar pjesët e sistemit që janë shkyçur;

7. "Strategjia e rienergjizimit nga lart–poshtë (*Top-Down Re-energisation Strategy – TD-RES*)" nënkupton një strategji që kërkon ndihmën e OST-ve të tjera për të rienergjizuar pjesët e sistemit të një OST;

8. "Strategjia e rienergjizimit nga poshtë–lart (*Bottom-Up Re-energisation Strategy – BU-RES*)" nënkupton një strategji ku pjesë të sistemit të një OST mund të rienergjizohen pa ndihmën e OST-ve të tjera;

9. "Risinkronizimi (*Resynchronisation – RS*)" nënkupton sinkronizimin dhe lidhjen përsëri të dy rajoneve të sinkronizuara në pikën e risinkronizimit;

10. "Lider i frekuencës (*Frequency Leader – FL*)" do të thotë OST-ja e caktuar dhe përgjegjëse për menaxhimin e frekuencës së sistemit brenda një rajoni të sinkronizuar ose një zone sinkrone, me qëllim që të rikthejë frekuencën e sistemit përsëri në frekuencën nominale;

11. "Rajon i sinkronizuar (*Synchronised Region – SR*)" nënkupton fraksionin e një zone sinkrone që mbulohet nga OST-të e ndërlidhura me një frekuencë të përbashkët të sistemit dhe që nuk është e sinkronizuar me pjesën tjetër të zonës sinkrone;

12. "Lideri i risinkronizimit (*Re-synchronisation Leader – RSL*)" nënkupton OST-në e caktuar dhe përgjegjëse për risinkronizimin e dy rajoneve të sinkronizuara;

13. "Pika e risinkronizimit (*Re-synchronisation Point – RSP*)" nënkupton pajisjen e përdorur për të lidhur dy rajone të sinkronizuara, zakonisht një ndërprerës.

Neni 4
Aspekte rregullatore

1. Gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje, palët kontraktuese, autoritetet rregullatore, subjektet kompetente dhe operatorët e sistemit, duhet:

a) të zbatojnë parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit;

b) të sigurojnë transparencë;

c) të zbatojnë parimin e optimizimit midis efikasitetit më të lartë të përgjithshëm dhe kostove totale më të ulëta për të gjitha palët e përfshira;

d) sigurohen që OST-të përdorin mekanizmat e bazuar në treg, për aq sa është e mundur për të garantuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit;

e) respektojnë kufizimet teknike, ligjore, të mbrojtjes personale dhe sigurisë;

f) respektojnë përgjegjësinë e caktuar për OST-në respektive, me qëllim garantimin e sigurisë së sistemit, duke përfshirë çfarë kërkohet nga legjislacioni kombëtar;

g) të konsultohen me OSSh-të respektive dhe të marrin parasysh ndikimet e mundshme në sistemin e tyre; dhe

h) të marrin në konsideratë standardet evropiane dhe specifikimet teknike të miratuara.

2. Secila OST do të dorëzojë propozimet e mëposhtme në Autoritetin Rregullator, në përputhje me nenin 59 të Direktivës (BE) 2019/944, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC, për miratim:

a) termat dhe kushtet për të vepruar si ofrues i shërbimeve të mbrojtjes mbi baza kontraktuale, në përputhje me paragrafin 4;

b) termat dhe kushtet për të vepruar si ofrues i shërbimeve të rivendosjes mbi baza kontraktuale, në përputhje me paragrafin 4;

c) listën e SGU-ve përgjegjëse për zbatimin në instalimet e tyre të masave që rezultojnë nga kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në Rregulloren (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, (BE) 2016/1388 të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC dhe (BE) 2016/1447 të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC dhe/ose nga legjislacioni dhe lista e masave që do të zbatohen nga këto SGU, të identifikuara nga OST-të sipas nenit 11 (4) (c) dhe 23 (4) (c);

d) listën e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit me prioritet të lartë të përmendur në nenet 11 (4) (d) dhe 23 (4) (d) ose parimet e zbatuara për t'i përcaktuar ato, si dhe termat dhe kushtet për shkyçjen dhe rienergjizimin e përdoruesve të rrjetit me prioritet të lartë, përveç nëse përcaktohen nga legjislacioni kombëtar i palëve kontraktuese;

e) rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut në përputhje me nenin 36 (1);

f) rregullat specifike për shlyerjen e disbalancave dhe energjisë balancuese në rast të pezullimit të aktiviteteve të tregut, në përputhje me nenin 39 (1);

g) planin e testimit në përputhje me nenin 43(2).

3. Nëse pala kontraktuese ka përcaktuar, propozimet e përmendura në pikat "a" deri në "d" dhe "g", të paragrafit 2, mund të paraqiten për miratim në një ent të ndryshëm nga autoriteti rregullator. Autoritetet rregullatore dhe subjektet e përcaktuara nga palët kontraktuese sipas këtij paragrafi do të vendosin mbi propozimet e përmendura në paragrafin 2, brenda gjashtë muajve nga data e paraqitjes nga OST-ja.

4. Termat dhe kushtet për të vepruar si ofrues i shërbimit të mbrojtjes dhe si ofruesi i shërbimit të rivendosjes do të vendosen ose në kuadrin ligjor kombëtar, ose me bazë kontraktuale. Nëse përcaktohet në baza kontraktuale, secila OST do të hartojë, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, një propozim për termat dhe kushtet përkatëse, të cilët do të përcaktojnë së paku:

a) karakteristikat e shërbimit që duhet të ofrohet;

b) mundësinë dhe kushtet për agregim; dhe

c) për ofruesit e shërbimeve të rivendosjes, hartën e shpërndarjes gjeografike të burimeve të energjisë me aftësi për operim në *black start* dhe operim.

5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo OST do të bëjë të ditur te autoriteti rregullator ose institucioni i caktuar nga pala kontraktuese planin e mbrojtjes së sistemit, të hartuar në përputhje me nenin 11 dhe planin e rivendosjes, të hartuar në pajtim me nenin 23 ose të paktën elementet e mëposhtme të këtyre planeve:

a) objektivat e planit të mbrojtjes së sistemit, si dhe planit të rivendosjes, duke përfshirë fenomenet që duhen menaxhuar ose situatat që duhet të zgjidhen.

6. kushtet që shkaktojnë aktivizimin e masave të planit të mbrojtjes dhe planin e rivendosjes të sistemit;

7. arsyetimi i secilës masë, duke shpjeguar se si kontribuon në arritjen e objektivave të planit të mbrojtjes dhe planit të rivendosjes së sistemit dhe palën përgjegjëse për zbatimin e këtyre masave;

8. afatet e përcaktuara në përputhje me nenet 11 dhe 23 për zbatimin e masave.

6. Kur një OST-je i kërkohet ose i lejohet sipas kësaj rregulloreje të specifikojë, të përcaktojë ose të pajtohet me kërkesat, termat dhe kushtet ose metodologjitë që nuk i nënshtrohen miratimit në përputhje me paragrafin 2, palët kontraktuese mund të kërkojnë miratimin paraprak nga autoriteti rregullator ose nga autoritetet e tjera të përcaktuara të palëve kontraktuese për këto kërkesa, terma dhe kushte ose metodologji.

7. Nëse një OST e konsideron të nevojshëm një amendim të dokumenteve, të miratuara në përputhje me paragrafin 3, për amendimin e propozuar do të zbatohen kërkesat e parashikuara në paragrafët 2 deri në 5. OST-të që propozojnë amendimin do të marrin parasysh pritshmërinë e ligjshme, aty ku është e nevojshme, të pronarëve të objekteve gjeneruese të energjisë, pronarëve të objekteve të kërkesës dhe palëve të tjera të interesit bazuar në kërkesat ose metodologjitë e specifikuara ose të dakorduara fillimisht.

8. Çdo palë mund të ankohet kundër një operatori respektiv sistemi ose OST-je, në lidhje me detyrimet ose vendimet e operatorit përkatës të sistemit ose të OST-së sipas kësaj rregulloreje dhe mund t'ia referojë ankesën autoritetit rregullator i cili, duke vepruar si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do të japë një vendim, brenda dy muajve pas pranimit të ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet me dy muaj të tjerë, kur nga autoriteti rregullator kërkohet informacion shtesë. Kjo periudhë e zgjatur mund të shtrihet më tej me marrëveshjen e ankuesit. Vendimi i autoritetit rregullator do të jetë i detyrueshëm nëse/dhe derisa të apelohet.

Neni 5

Konsultimi dhe koordinimi

1. Kur kjo rregullore parashikon që një OST do të konsultohet me palët e interesit në fjalë për veprimet që ajo përcakton para kohës reale ose në kohë reale, zbatohet procedura e mëposhtme:

a) OST-ja do të ndërveprojë me të paktën palët e identifikuara në nenet e kësaj rregulloreje që kërkojnë konsultim;

9. OST-ja do të shpjegojë arsyetimin dhe objektivin e konsultimit dhe të vendimit që duhet të marrë;

10. OST-ja do të mbledhë nga palët e përmendura në pikën "a" çdo informacion respektiv dhe vlerësimin e tyre;

11. OST-ja do të marrë parasysh pikëpamjet, rrethanat dhe kufizimet e palëve të konsultuara;

12. para marrjes së vendimit, OST-ja do të japë një shpjegim për palët e konsultuara për arsyet për pasqyrimin ose jo të pikëpamjeve të tyre.

2. Kur kjo rregullore parashikon që një OST të koordinojë ekzekutimin e një grupi veprimesh në kohë reale me disa palë, zbatohet procedura,, si më poshtë:

a) OST-ja do të ndërveprojë së paku me palët e identifikuara në nenet e kësaj rregulloreje që kërkojnë koordinim në kohë reale;

13. OST-ja do të shpjegojë arsyetimin dhe objektivin e koordinimit dhe të veprimeve që duhet të ndërmerren;

14. OST-ja do të bëjë propozimin fillestar mbi veprimet që duhet të ndërmerren nga secila palë;

15. OST-ja do të mbledhë nga palët e përmendura në pikën "a" çdo informacion të rëndësishëm dhe vlerësimin e tij;

16. OST-ja do të bëjë një propozimin përfundimtar mbi veprimet që duhet të ndërmerren nga secila palë, duke marrë parasysh pikëpamjet, kushtet dhe kufizimet e palëve në fjalë dhe duke caktuar një afat kohor për palët që të shprehin kundërshtimin e tyre ndaj veprimeve të propozuara nga OST-ja;

17. kur palët e interesuara nuk kundërshtojnë ekzekutimin e veprimeve të propozuara nga OST-ja, secila palë, duke përfshirë edhe OST-në, do të zbatojë veprimet në përputhje me propozimin;

18. aty ku një ose disa nga palët refuzojnë veprimin e propozuar nga OST-ja brenda afatit të përcaktuar, OST-ja do t'ia referojë veprimin e propozuar autoritetit përkatës për vendim, së bashku me arsyet dhe shpjegimet, si dhe objektivat e veprimit të propozuar nga OST-ja dhe të vlerësimit dhe pozicionit të palëve;

19. nëse referimi në kohë reale tek autoriteti përkatës nuk është i mundur, OST-ja do të iniciojë një veprim ekuivalent, i cili ka më pak ose aspak ndikim tek palët që refuzuan të zbatojnë veprimin e propozuar.

3. Një palë mund të refuzojë të ekzekutojë veprimet në kohë reale të propozuara nga OST-ja sipas procedurës së koordinimit të përshkruar në paragrafin 2, nëse arsyeton që veprimi i propozuar do të çonte në shkeljen e një ose më shumë kufizimeve teknike, ligjore, të sigurisë personale ose kushtëzimet e sigurisë.

Neni 6

Koordinimi rajonal

1. Gjatë hartimit të planit të mbrojtjes së sistemit në përputhje me nenin 11 dhe planit të tij të rivendosjes në përputhje me nenin 23 ose kur rishikon planin e mbrojtjes së sistemit në përputhje me nenin 50 dhe planin e rivendosjes në përputhje me nenin 51, secila OST duhet të sigurojë konsistencën e masave përkatëse në planet e OST-ve brenda zonës sinkrone dhe në planet e OST-ve fqinje që i përkasin një zone tjetër sinkrone së paku për masat e mëposhtme:

a) asistenca dhe koordinimi ndërmjet OST-ve në gjendjen e emergjencës, në përputhje me nenin 14;

20. procedurat e menaxhimit të frekuencës, në pajtim me nenin 18 dhe nenin 28, duke përjashtuar vendosjen e frekuencës target, në rastin e një strategjie të rienergjizimit nga poshtë–lart para çdo risinkronizimi në sistemin e transmetimit të interkonektuar;

21. mbështetje për procedurën e fuqisë aktive, në përputhje me nenin 21;

22. strategjinë e rienergjizimit nga lart–poshtë, në përputhje me nenin 27.

2. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së planit të mbrojtjes dhe të rivendosjes së sistemit, në përputhje me paragrafin 1 do të përfshijë detyrat e mëposhtme:

a) shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave që lidhen me masat e përmendura në paragrafin 1 në mesin e OST-ve në fjalë;

b) identifikimin e papajtueshmërisë së masave të përmendura në paragrafin 1, në planet e OST-ve të përfshira;

c) identifikimin e kërcënimeve të mundshme të sigurisë operacionale në rajonin e llogaritjes së kapacitetit. Këto kërcënime përfshijnë, ndër të tjera, avaritë e regjimit të përbashkët rajonal me ndikim të rëndësishëm në sistemet e transmetimit të OST-ve të përfshira;

d) vlerësimin e efikasitetit të masave të përmendura në paragrafin 1 të përcaktuar në planet e mbrojtjes dhe rivendosjes së sistemit të OST-ve të përfshira, për të menaxhuar kërcënimet potenciale të përmendura në pikën “c”;

e) konsultimet me Qendrat Rajonale të Koordinimit (RCC-të) për të analizuar konsistencën e masave të përmendura në paragrafin 1 brenda të gjithë zonës përkatëse sinkrone;

f) identifikimin e veprimeve përmirësuese në rast të papajtueshmërive në planet e mbrojtjes dhe planeve të rivendosjes së sistemit të OST-ve të përfshira ose nëse mungojnë masat në planet e mbrojtjes së sistemit dhe planet e rivendosjes të OST-ve të përfshira.

3. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, secila OST do t’i transmetojë masat e përmendura në paragrafin 1 te RCC-të respektive të krijuara në bazë të nenit 35 të Rregullores (BE) 2019/943, e përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC. Brenda 3 muajve nga paraqitja e masave, RCC (të) do të hartojë një raport teknik për konsistencën e masave bazuar në kriteret e përcaktuara në paragrafin 2. Secila OST do të sigurojë disponueshmërinë e ekspertëve të tij të aftë për të ndihmuar RCC (të) në përgatitjen e këtij raporti.

4. RCC-ja do të përcjellë pa vonesë raportin teknik të përmendur në paragrafin 3, të gjitha OST-ve të përfshira, të cilat më pas ia përcjellin atë autoriteteve respektive rregullatore, si dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO-E, për qëllime të nenit 52.

5. Të gjitha OST-të e secilit rajon të llogaritjes së kapacitetit do të bien dakord mbi pragun mbi të cilin ndikimi i veprimeve të një ose më shumë OST-ve në gjendjen e emergjencës, *blackout*-it ose rivendosjes konsiderohet i rëndësishëm për OST-të e tjera brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit.

Neni 7
Konsultimi publik

1. OST-të respektive do të konsultohen me palët e interesit, duke përfshirë autoritetet kompetente të çdo pale kontraktuese, mbi propozimet që i nënshtrohen miratimit në përputhje me pikat “a”, “b”, “e”, “f” dhe “g”, të nenit 4 (2). Konsultimi do të zgjasë për periudhën e kohës prej jo më pak së një muaj.

2. OST-të përkatëse duhet të marrin siç duhet në konsideratë pikëpamjet e palëve të interesuara që rezultojnë nga konsultimet para dorëzimit të draftpropozimit. Në të gjitha rastet duhet të sigurohet një justifikim i shëndoshë për përfshirjen ose mospërfshirjen e pikëpamjeve të palëve të interesit i cili duhet të publikohet në kohën e duhur përpara ose njëkohësisht me publikimin e propozimit.

Neni 8
Mbulimi i kostove

1. Shpenzimet e operatorëve të sistemit që i nënshtrohen rregullimit të tarifave të rrjetit dhe që rrjedhin nga detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të vlerësohen nga autoritetet respektive rregullatore në përputhje me nenin 59 të Direktivës (BE) 2019/944, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC. Kostot e vlerësuara si të arsyeshme, efikase dhe proporcionale duhet të mbulohen përmes tarifave të rrjetit ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm.

2. Nëse kërkohet nga autoritetet respektive rregullatore, operatorët e sistemit të përmendur në paragrafin 1 brenda tre muajve nga kërkesa ofrojnë informacionin e nevojshëm për të lehtësuar vlerësimin e shpenzimeve të bëra.

Neni 9
Detyrimet e konfidencialitetit

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar në pajtim me këtë rregullore i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuar në paragrafët 2, 3 dhe 4.

2. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet për çdo person që i nënshtrohet dispozitave të kësaj rregulloreje.

3. Informacioni konfidencial i marrë nga personat e përmendur në paragrafin 2 gjatë kryerjes së detyrave të tyre nuk mund të zbulohet tek ndonjë person apo autoritet tjetër, pa paragjykuar rastet që mbulohen nga legjislacioni kombëtar, dispozitat e tjera të kësaj rregullore ose legjislacioni tjetër përkatës i Komunitetit të Energjisë dhe kombëtar.

4. Pa paragjykuar rastet e mbuluara nga legjislacioni i Komunitetit të Energjisë dhe kombëtar, autoritetet rregullatore, organet ose personat që marrin informacion konfidencial sipas kësaj rregulloreje, mund ta përdorin atë vetëm për qëllime të kryerjes së detyrave të tyre sipas kësaj rregulloreje.

Neni 10
Marrëveshja me OST-të që nuk detyrohen nga kjo rregullore

Kur një zonë sinkrone përfshin si OST-të e Komunitetit të Energjisë ashtu edhe të një vendi të tretë, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, të gjitha OST-të e palëve kontraktuese në atë zonë sinkrone do të përpiqen të përfundojnë me OST-të e vendeve të treta të cilat nuk janë të detyruara nga kjo rregullore një marrëveshje që përcakton bazën për bashkëpunimin e tyre, në lidhje me operimin e sigurt të sistemit dhe përcaktimin e marrëveshjeve për pajtueshmërinë e OST-ve të vendit të tretë me detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore.

KAPITULLI II
PLANI I MBROJTJES SË SISTEMIT

SEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 11
Hartimi i planit të mbrojtjes së sistemit

1. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, secila OST në konsultim me OSSh-të respektive, SGU-të, autoritetet rregullatore kombëtare ose institucionet e përmendura në nenin 4 (3), OST-të fqinje dhe OST-të e tjera në zonën sinkrone, do të hartojë planin e mbrojtjes së sistemit.

2. Gjatë hartimit të planit të mbrojtjes së sistemit, secila OST duhet të marrë parasysh të paktën elementet e mëposhtme:

a) kufijtë e sigurisë operacionale të përcaktuar në përputhje me nenin 25 të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC;

23. sjelljen dhe aftësitë e ngarkesës dhe gjenerimit brenda zonës sinkrone;

24. nevojat specifike të përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit me prioritet të lartë të listuar sipas pikës “d”, të paragrafit 4; dhe

25. karakteristikat e sistemit të tij të transmetimit dhe të sistemeve bazë të OSSh-ve.

3. Plani i mbrojtjes së sistemit duhet të përmbajë së paku dispozitat, si më poshtë:

a) kushtet në të cilat aktivizohet plani i mbrojtjes së sistemit, në përputhje me nenin 13;

26. udhëzimet e planit të mbrojtjes të sistemit që duhet të lëshohen nga OST-të; dhe

27. masat që i nënshtrohen konsultimit në kohë reale ose koordinimit me palët e identifikuara.

4. Në veçanti, plani i mbrojtjes së sistemit duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

a) listën e masave që duhet të zbatohet nga OST-ja në instalimet e saj;

28. listën e masave që do të zbatohet nga OSSh-të dhe OSSh-të përgjegjëse për zbatimin e këtyre masave në instalimet e tyre;

29. listën e SGU-ve përgjegjëse për zbatimin në instalimet e tyre të masave si rrjedhojë e kërkesave të detyrueshme të përcaktuara në Rregulloren (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, (BE) 2016/1388 të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC dhe (BE) 2016/1447 të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC ose nga legjislacioni kombëtar dhe listën e masave që duhet të zbatohet nga ato SGU;

30. listën e përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit me prioritet të lartë me afatet dhe kushtet për shkyçjen e tyre; dhe

31. afatet e zbatimit për secilën masë të listuar në planin e mbrojtjes së sistemit.

5. Plani i mbrojtjes së sistemit duhet të përfshijë të paktën masat e mëposhtme teknike dhe organizative të specifikuara në seksionin 2, të kapitullit II:

a) skemat e mbrojtjes së sistemit, duke përfshirë së paku:

i. skemën automatike të kontrollit në nënfrekuencë, në përputhje me nenin 15;

ii. skemën automatike të kontrollit në mbifrekuencë, në përputhje me nenin 16;

iii. skemën automatike të kontrollit kundrejt kolapsit të tensionit, në përputhje me nenin 17;

32. procedurat e planit të mbrojtjes së sistemit, duke përfshirë së paku:

i. procedurën e menaxhimit të devijimit të frekuencës, në përputhje me nenin 18;

ii. procedurën e menaxhimit të devijimit të tensionit, në përputhje me nenin 19;

iii. procedurën e menaxhimit të flukseve të fuqisë, në përputhje me nenin 20;

iv. suporti për procedurën e fuqisë aktive, në përputhje me nenin 21;

v. procedura e shkyçjes manualisht të kërkesës, në përputhje me nenin 22.

6. Masat e përfshira në planin e mbrojtjes së sistemit duhet të jenë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) impakti i tyre në përdoruesit e sistemit duhet të jetë minimal:

33. ato duhet të jenë ekonomikisht efikase;

34. duhet të aktivizohen vetëm ato masa që janë të nevojshme;

35. ato nuk çojnë sistemin e transmisionit të OST-së ose sistemet e transmetimit të interkonektuar në gjendje emergjence ose gjendje *blackout*-i.

Neni 12

Implementimi i planit të mbrojtjes së sistemit

1. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje secila OST duhet të zbatojë këto masa të planit të tij të mbrojtjes së sistemit që duhet të zbatohen në sistemin e tij të transmetimit. Që nga ky moment ai duhet t'i mbajë masat e zbatuara.

2. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje secila OST do të njoftojë OSSh-në e lidhur me sistemin e transmetimit, duke përfshirë edhe afatet për implementim, të cilat do të zbatohen mbi:

a) instalimet e OSSh-ve në pajtim me neni 11(4);ose

36. instalimet e SGU-ve të identifikuara në përputhje me nenin 11 (4) të lidhur me sistemet e tyre të shpërndarjes; ose

37. instalimet e siguruesve të shërbimit të mbrojtjes të lidhur në sistemet e tyre të shpërndarjes; ose

38. instalimet e OSSh-ve të lidhura në sistemet e tyre të shpërndarjes.

3. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, secila OST do të njoftojë SGU-të e identifikuara sipas pikës "c", të nenit 11 (4) ose siguruesit e shërbimit të mbrojtjes të lidhur drejtpërdrejt me sistemin e tij të transmetimit për masat që duhet të zbatohen në instalimet e tyre, duke përfshirë afatet për implementim.

4. Kur parashikohet në legjislacionin kombëtar, OST-ja do të njoftojë direkt SGU-të e identifikuara sipas pikës "c", të nenit 11 (4), siguruesit e shërbimit të mbrojtjes ose OSSh-në e lidhur në sistemin e shpërndarjes, për masat që duhet të zbatohen në instalimet e tyre, duke përfshirë afatet për implementim e tyre. Ai do të informojë OSSh-në respektive për këtë njoftim.

5. Kur një OST njofton një OSSh, në përputhje me paragrafin 2, OSSh-ja do të njoftojë menjëherë, pa vonesë, SGU-të, siguruesit e shërbimit të mbrojtjes dhe OSSh-të e lidhura me sistemin e tij të shpërndarjes për masat e planit të mbrojtjes së sistemit që ata duhet të zbatojnë në instalimet e tyre përkatëse, duke përfshirë afatet për implementimin e tyre.

6. Çdo OSSh e njoftuar, SGU dhe ofrues i shërbimit të mbrojtjes duhet:

a) të zbatojë masat e njoftuara në pajtim me këtë nen jo më vonë së 12 muaj nga data e njoftimit;

39. t'i konfirmojë operatorit të sistemit që ka bërë njoftimin, zbatimin e masave i cili, kur është i ndryshëm nga OST-ja, njofton konfirmimin tek OST-ja; dhe

40. të mbajë masat e zbatuara mbi instalimet e tij.

Neni 13

Aktivizimi i planit të mbrojtjes së sistemit

1. Çdo OST do të aktivizojë procedurat e planit të mbrojtjes së sistemit, në përputhje me pikën "b", të nenit 11 (5) në koordinim me OSSh-të dhe SGU-të e identifikuar sipas nenit 11 (4) dhe me siguruesit e shërbimit të mbrojtjes.

2. Përveç skemave të aktivizuara automatikisht të planit të mbrojtjes së sistemit, në përputhje me pikën "a", të nenit 11 (5), secila OST do të aktivizojë procedurën e planit të mbrojtjes së sistemit kur:

a) sistemi është në gjendje emergjence, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 18 (3) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC dhe nuk ka veprime përmirësuese në dispozicion për të rikthyer sistemin në gjendjen normale; ose

41. bazuar në analizën e sigurisë operacionale, siguria operacionale e sistemit të transmetimit kërkon aktivizimin e një mase të planit të mbrojtjes së sistemit, në përputhje me nenin 11 (5), krahas veprimeve përmirësuese në dispozicion.

3. Çdo OSSh dhe SGU e identifikuar sipas nenit 11 (4), si dhe çdo ofrues i shërbimeve të mbrojtjes duhet të zbatojë pa vonesa të panevojshme udhëzimet e planit të mbrojtjes të sistemit të lëshuara nga OST-ja në përputhje me pikën "c", të nenit 11 (3), në përputhje me procedurat e planit të mbrojtjes të sistemit të parashikuara në pikën "b", të nenit 11 (5).

4. Çdo OST do të aktivizojë procedurat e planit të mbrojtjes së sistemit të përmendur në pikën "b", të nenit 11 (5) që kanë një ndikim të rëndësishëm ndërkufitar në koordinim me OST-të e prekura.

Neni 14

Ndihma dhe koordinimi në gjendjen e emergjencës ndërmjet OST-ve

1. Me kërkesë të një OST-je në gjendje emergjence, secila OST do të ofrojë nëpërmjet interkonektorëve çdo ndihmë të mundshme për OST-në që e kërkon, me kusht që kjo të mos shkaktojë hyrjen në gjendje emergjence ose *blackout*-i të sistemit të saj të transmetimit ose sistemeve të transmetimit të interkonektuar.

2. Kur asistenca duhet të sigurohet nëpërmjet interkonektorëve me rrymë të vazhduar, duke marrë parasysh karakteristikat teknike dhe aftësinë e sistemit HVDC, ndihma mund të konsistojë në kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

a) veprime të rregullimit manual të fuqisë aktive të transmetuar për të ndihmuar OST-në në gjendje emergjence për të sjellë flukset e energjisë brenda limiteve të sigurisë operacionale ose frekuencën e zonës sinkrone fqinje brenda kufijve të frekuencës së sistemit për gjendjen e alarmit, të përcaktuar në përputhje me nenin 18 (2) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC;

42. funksionet automatike të kontrollit të fuqisë aktive të transmetuar bazuar në sinjalet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 13 të Rregullores(BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC;

43. kontrollin automatik të frekuencës në përputhje me nenet 15 deri 18, të Rregullores (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC në rastin e operimit ishull;

44. kontrollin e tensionit dhe fuqisë reaktive, në përputhje me nenin 24 të Rregullores (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04PHLG-EnC; dhe

45. çdo veprim tjetër të përshtatshëm.

3. Çdo OST mund të procedojë me shkyçjen manuale të çdo elementi të sistemit të transmetimit që ka ndikim të rëndësishëm ndërkufitar, përfshirë një interkonektor, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) OST-ja do të koordinojë me OST-të fqinje; dhe

46. ky veprim nuk do të çojë sistemin e transmetimit të mbetur të ndërlidhur, në gjendje emergjence ose gjendje *blackout*-i.

4. Pavarësisht nga paragrafi 3, një OST mund të shkyçë manualisht pa koordinim çdo element të sistemit të transmetimit që ka një ndikim të konsiderueshëm ndërkufitar, duke përfshirë një interkonektor, në rrethana të jashtëzakonshme që nënkuptojnë cenim të kufijve të sigurisë operacionale, për të parandaluar rrezikimin e sigurisë së personelit ose dëmtimin e pajisjeve. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST-ja do të përgatisë një raport, të paktën në gjuhën angleze, që përmban një shpjegim të detajuar të arsyeve, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe t'ia dorëzojë atë autoritetit përkatës rregullator, në përputhje me nenin 59 të Direktivës (BE) 2019/944, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC dhe OST-ve fqinje, dhe ta bëjnë të disponueshëm për përdoruesit e sistemit të prekur në mënyrë të konsiderueshme.

SEKSIONI 2
MASAT E PLANIT TË MBROJTJES SË SISTEMIT

Neni 15
Skema e kontrollit automatik në nënfrekuencë

1. Skema për kontrollin automatik në nënfrekuencë të planit të mbrojtjes së sistemit duhet të përfshijë një skemë për shkyçjen automatike të kërkesës në frekuencë të ulët dhe parametrizimet e modalitetit LFSM-U në zonën e kontrollit LFC të OST-së.

2. Në dizajnin e planit të tij të mbrojtjes së sistemit, çdo OST duhet të sigurojë aktivizimin në modalitetin LFSM-U para aktivizimit të skemës së shkyçjes automatike të kërkesës nga frekuenca e ulët, me kusht që gradienti i ndryshimit të frekuencës ta lejojë atë.

3. Para aktivizimit të skemës automatike të shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët, secila OST dhe OSSh, e identifikuar sipas nenit 11 (4), duhet të parashikojë që njësitë e rezervimit të energjisë që veprojnë si ngarkesë të lidhur me sistemin e tij:

a) kalon automatikisht në modalitetin gjenerim brenda kufirit kohor dhe në pikën e caktuar të fuqisë aktive të përcaktuar nga OST-ja në planin e mbrojtjes së sistemit; ose

47. kur njësia e rezervimit të energjisë nuk është në gjendje të kyçet brenda afatit kohor të përcaktuar nga OST-ja në planin e mbrojtjes së sistemit, automatikisht shkyçet njësia e rezervimit të energjisë që vepron si ngarkesë;

4. Secila OST duhet të përcaktojë në planin e mbrojtjes së saj pragjet e frekuencës në të cilat do të ngjasë kyçja ose shkyçja automatike e njësive të rezervimit të energjisë. Këto pragje frekuence duhet të jenë më të ulta ose të barabarta me kufirin e frekuencës së sistemit të përcaktuar për gjendjen e emergjencës në nenin 18 (3) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC dhe më të larta së

kufiri i frekuencës për shkyçjen e kërkesës në nivelin fillestar të detyrueshëm të përcaktuar në shtojcë.

5. Secila OST do të hartojë skemën e shkyçjes automatike të kërkesës për frekuencë të ulët, në përputhje me parametrat për shkarkimin e ngarkesës në kohë reale të përcaktuar në shtojcë. Skema duhet të përfshijë shkyçjen e kërkesës në frekuenca të ndryshme, nga "niveli fillestar i detyrueshëm" në një "nivel përfundimtar të detyrueshëm", brenda një diapazoni zbatimi, duke respektuar një numër minimal dhe madhësinë maksimale të hapave. Diapazoni i zbatimit do të përcaktojë devijimin maksimal të lejuar të kërkesës neto të shkyçur nga kërkesa neto e synuar që do të shkyçet për një frekuencë të caktuar, i llogaritur nëpërmjet një interpolimi linear ndërmjet niveleve fillestare dhe përfundimtare të detyrueshme. Diapazoni i zbatimit nuk do të lejojë shkyçjen e kërkesës neto më pak se shuma e kërkesës neto që shkyçet në nivelin fillestar të detyrueshëm. Një hap nuk mund të konsiderohet si i tillë nëse asnjë kërkesë neto nuk është shkyçur kur arrihet ky hap.

6. Çdo OST ose OSSh duhet të instalojnë releté e nevojshme për shkyçjen e kërkesës në frekuencë të ulët, duke marrë parasysh të paktën sjelljen e ngarkesës dhe gjenerimin e shpërndarë.

7. Gjatë implementimit të skemës për shkyçje automatike të kërkesës për frekuencë të ulët, në pajtim me njoftimin sipas nenit 12 (2), secila OST ose OSSh, duhet:

a) të shmangë vendosjen e vonesës së qëllimshme të kohës, përveç kohës së funksionimit të releve dhe të ndërprerësve;

48. të minimizojë shkyçjen e moduleve gjeneruese të energjisë, veçanërisht ata që sigurojnë inerci; dhe

49. kufizojë rrezikun që skema të çojë në devijime të flukseve të energjisë dhe devijime të tensionit jashtë kufijve të sigurisë operacionale.

Nëse një OSSh nuk mund të përmbushë kërkesat sipas pikave "b" dhe "c", ai duhet të njoftojë OST-në dhe të propozojë së cila kërkesë do të zbatohet. OST-ja, në konsultim me OSSh-në do të përcaktojë kërkesat e zbatueshme në bazë të një analize të përbashkët kosto–përfitimi.

8. Skema e planit të mbrojtjes së sistemit për shkyçjen automatike të kërkesës për frekuencë të ulët mund të sigurojë shkyçjen e kërkesës së netuar bazuar në gradientin e frekuencës, me kusht që:

a) aktivizohet vetëm nëse:

i. kur devijimi i frekuencës është më i lartë së devijimi maksimal i frekuencës së gjendjes së qëndrueshme dhe gradienti i frekuencës është më i lartë së ai i shkaktuar nga incidenti referent;

ii. derisa frekuenca të arrijë frekuencën e shkyçjes së kërkesës, duke filluar nga niveli i detyrueshëm;

50. është në përputhje me aneksin; dhe

51. është e nevojshme dhe e justifikuar për të ruajtur në mënyrë efikase sigurinë operacionale.

9. Në rast se skema e planit të mbrojtjes së sistemit për shkyçjen automatike të kërkesës në frekuencë të ulët përfshin shkyçjen e kërkesës neto të bazuar në gradientin e frekuencës, siç përshkruhet në paragrafin 8, OST-ja do të paraqesë, brenda 30 ditëve nga implementimi, raportin që përmban informacionin e detajuar të arsyetimit, zbatimit dhe ndikimit të kësaj mase tek autoriteti rregullator kombëtar.

10. Një OST mund të përfshijë në skemën e planit të mbrojtjes për shkyçjen automatike të kërkesës në frekuencë të ulët, hapa shtesë për shkyçjen e kërkesës së netuar, nën nivelin e detyrueshëm përfundimtar të shkyçjes së kërkesës të përcaktuar në aneks.

11. Çdo OST do të ketë të drejtë të implementojë skema shtesë të mbrojtjes së sistemit që aktivizohen nga një frekuencë më e vogël ose e barabartë me frekuencën e nivelit përfundimtar të detyrueshëm të shkyçjes së kërkesës dhe që synojnë një proces më të shpejtë të rivendosjes. OST-ja do të sigurohet që skema të tilla shtesë të mos përkeqësojnë më tej frekuencën.

Neni 16

Skema e kontrollit automatik në mbifrekuencë

1. Skema për kontrollin automatik në mbifrekuencë e planit të mbrojtjes së sistemit duhet të çojë në një ulje automatike të fuqisë totale aktive të injektuar në secilën zonë LFC.

2. Në konsultim me OST-të e tjera të zonës sinkrone, secila OST do të përcaktojë parametrat e mëposhtëm të skemës së tij për kontrollin automatik në mbifrekuencë:

a) pragjet e frekuencës për aktivizimin e tij;

52. raportin e reduktimit të injektimit të fuqisë aktive.

3. Secila OST duhet të përcaktojë skemën e saj automatike të kontrollit të frekuencës, duke marrë parasysh aftësitë e moduleve gjeneruese të energjisë, në lidhje me modalitetin në LFSM-O dhe të njësive të rezervimit të energjisë, në zonën e tij të LFC-së. Nëse modaliteti në LFSM-O nuk ekziston ose nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat "a" dhe "b", të paragrafit 2, secila OST, përveç të tjerave, do të krijojë shkyçjen me hapa të gjenerimit në drejtimin linear në zonën e tij LFC. OST-ja do të përcaktojë madhësinë maksimale të hapave për shkyçjen e moduleve gjeneruese të energjisë dhe/ose të sistemeve HVDC në konsultim me OST-të e tjera të zonës sinkrone.

Neni 17

Skema automatike kundër kolapsit të tensionit

1. Skema automatike kundër kolapsit të tensionit e planit të mbrojtjes së sistemit mund të përfshijë një ose më shumë nga skemat e mëposhtme në varësi të rezultateve të vlerësimit të sigurisë së sistemit të OST-së:

a) Skema e shkyçjes së kërkesës nga tensioni i ulët në përputhje me nenin 19(2) të Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04PHLG-EnC; dhe

53. Skema e bllokimit automatik të rregullatorit të tensionit në ngarkesë, në pajtim me nenin 19 (3), të Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04PHLG-EnC; dhe

54. Skemat e mbrojtjes së sistemit për menaxhimin e tensionit.

2. Përveç nëse në pajtim me paragrafin 1, vlerësimi demonstron që implementimi i skemës së bllokimit automatik të rregullatorit të tensionit në ngarkesë nuk është i nevojshëm për të parandaluar një kolaps të tensionit në zonën e kontrollit të OST-së, OST-ja do të përcaktojë kushtet nën të cilat do të bllokojë rregullatorin e tensionit në ngarkesë, në pajtim me nenin 19 (3) të Rregullores (BE) 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC, duke përfshirë së paku:

a) metodën e bllokimit (lokale apo në distancë nga dhoma e kontrollit);

55. pragun e nivelit të tensionit në pikën e lidhjes;

56. drejtimin e flukseve të fuqisë reaktive; dhe

57. maksimumin e vonesës në kohë ndërmjet detektimit të pragut dhe bllokimit.

Neni 18

Procedura e menaxhimit të devijimit të frekuencës

1. Procedura për menaxhimin e devijimeve të frekuencës së planit të mbrojtjes së sistemit duhet të përmbajë një grup masash për të menaxhuar devijimin e frekuencës jashtë kufijve të frekuencës të përcaktuar për gjendjen e alarmit në nenin 18 (2), të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC. Procedura e menaxhimit të devijimit të frekuencës duhet të jetë në përputhje me procedurat e përcaktuara për veprimet përmirësuese të cilat duhet të menaxhohen në mënyrë të koordinuar në përputhje me nenin 78 (4) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2022/03/PHLG-EnC dhe duhet të përmbushin të paktën kërkesat e mëposhtme:

a) zvogëlimi i gjenerimit duhet të jetë më i vogël së zvogëlimi i ngarkesës gjatë ngjarjeve në nënfrekuencë; dhe

58. zvogëlimi i gjenerimit duhet të jetë më i madh se zvogëlimi i ngarkesës gjatë ngjarjeve në mbifrekuencë.

2. Çdo OST duhet të përshtatë mënyrën e operimit të LFC-së së tij për të parandaluar ndërhyrjen në aktivizimin manual ose çaktivizimin e fuqisë aktive, siç përcaktohet në paragrafët 3 dhe 5.

3. Secila OST ka të drejtën të përcaktojë një *set point* të fuqisë aktive që çdo SGU e identifikuar sipas pikës "c", të nenit 11 (4) duhet të mbajë, me kusht që *set point*-i të përmbushë kufizimet teknike të SGU-ve. Secila OST ka të drejtë të përcaktojë një *set point* të fuqisë aktive që secili ofrues i shërbimit të mbrojtjes duhet të mbajë, me kusht që kjo masë të zbatohet mbi ta sipas termave dhe kushteve të përmendura në nenin 4 (4) dhe *set point*-i i tij respekton kufizimet teknike të ofruesit të shërbimit të mbrojtjes. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes duhet të zbatojnë pa vonesë të panevojshme udhëzimet e dhëna nga OST-ja direkt ose indirekt nëpërmjet OSSh-së dhe do të qëndrojnë në atë gjendje deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur udhëzimet jepen drejtpërdrejt, OST-ja do të informojë OSSh-në respektive pa vonesë të panevojshme.

4. Secila OST ka të drejtë të shkyçë SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes, drejtpërdrejt ose indirekt nëpërmjet OSSh-ve. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes do të mbeten të shkëputur deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur SGU-të shkyçen direkt, OST-ja do të informojë OSSh-në përkatëse pa vonesë të panevojshme. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST-ja do të përgatisë një raport që përmban një shpjegim të hollësishëm të arsyetimit, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe t'ia dorëzojë atë autoritetit rregullator përkatës, në përputhje me nenin 59 të Direktivës (BE) 2019/944, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC, si dhe e bëjnë atë të disponueshme për përdoruesit e sistemit të prekur ndjeshëm.

5. Para aktivizimit të skemës automatike të shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët, të përcaktuar në nenin 15 dhe me kusht që gradienti i ndryshimit të frekuencës ta lejojë atë, secila OST, direkt ose indirekt nëpërmjet OSSh-së, do aktivizojë përgjigjen e kërkesës nga ofruesit respektivë të shërbimit të mbrojtjes; dhe:

a) kalojnë njësitë e rezervimit të energjisë që veprojnë si ngarkesë në regjimin në gjenerim në një *set point* të fuqisë aktive të përcaktuar nga OST-ja në planin e mbrojtjes së sistemit; ose

59. kur njësia e rezervimit të energjisë nuk është e aftë të kyçet shpejt sa duhet për të stabilizuar frekuencën, manualisht shkëput njësinë e rezervimit të energjisë.

Neni 19

Procedura e menaxhimit të devijimit të tensionit

1. Procedura e menaxhimit të devijimit të tensionit të planit të mbrojtjes së sistemit do të përmbajë një grup masash për të menaxhuar tensionin jashtë limiteve të sigurisë operacionale të përcaktuar në nenin 25 të Rregullores BE 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC.

2. Çdo OST do të ketë të drejtë të përcaktojë diapazonin e fuqisë reaktive ose diapazonin e tensionit dhe të udhëzojë OSSh-të dhe SGU-të e identifikuar për këtë masë në pajtim me neni 11(4) për ta mirëmbajtur atë, në pajtim me nenet 28 dhe 29, të Rregullores së BE 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC.

3. Me kërkesë të OST-së fqinje në gjendje emergjence, çdo OST do të bëjë të disponueshme të gjitha aftësitë për fuqi reaktive që nuk e çojnë sistemin e tij në gjendje emergjence ose *blackout*-i.

Neni 20

Procedura e menaxhimit të flukseve të fuqisë

1. Procedura e planit të mbrojtjes së sistemit për menaxhimin e flukseve të fuqisë duhet të përfshijë një grup masash për të menaxhuar flukset e fuqisë jashtë kufijve të sigurisë operacionale të përcaktuara në nenin 25 të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC.

2. Secila OST ka të drejtën të përcaktojë një *set point* të fuqisë aktive që secila SGU e identifikuar sipas pikës "c", të nenit 11 (4), duhet të mbajë, me kusht që *set pointi* i caktuar të respektojë kufizimet teknike të SGU-së. Secila OST ka të drejtë të përcaktojë një *set point* të fuqisë aktive që secili ofrues i shërbimit të mbrojtjes do të mbajë, me kusht që kjo masë mbi ta të zbatohet sipas termave dhe kushteve të përmendura në nenin 4 (4) dhe *set pointi* respekton kufizimet teknike të ofruesit të shërbimit të mbrojtjes. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes duhet të zbatojnë pa vonesë të panevojshme udhëzimet e dhëna nga OST-ja, direkt ose indirekt, nëpërmjet OSSh-së dhe do të qëndrojnë në atë gjendje deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur udhëzimet jepen drejtpërdrejt, OST-ja do të informojë OSSh-të përkatëse pa vonesë të panevojshme.

3. Çdo OST ka të drejtë të shkyçë SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes, drejtpërdrejt ose indirekt nëpërmjet OSSh-ve. SGU-të dhe ofruesit e shërbimit të mbrojtjes do të mbeten të shkëputur deri në lëshimin e udhëzimeve të mëtejshme. Kur SGU-të shkyçen drejtpërdrejt, OST-ja do të informojë OSSh-të respektive pa vonesë të panevojshme. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST-ja do të përgatisë një raport që përmban një shpjegim të detajuar të arsyetimit, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe ia dorëzon atë autoritetit përkatës rregullator, në përputhje me nenin 59 të Direktivës së BE 2019/944, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC.

Neni 21

Mbështetja për procedurën e fuqisë aktive

1. Në rast të mungesës së mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit për periudhën kohore të ditës në avancë ose brenda ditës, të identifikuar sipas paragrafëve 1 dhe 2, të nenit 107, të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC, dhe para çdo pezullimi të mundshëm të aktiviteteve të tregut, në pajtim me nenin 35, OST-ja do të ketë të drejtë të kërkojë mbështetje për energji aktive nga:

a) çdo ofrues shërbimi balancues, i cili, me kërkesën e OST-së, do të ndryshojë statusin e tij të disponueshmërisë për të vënë në dispozicion të gjithë fuqinë aktive të tij, me kusht që ajo të mos jetë e aktivizuar akoma në tregun balancues dhe në përputhje me kufizimet e tij teknike;

60. çdo SGU, i lidhur në zonën e tij të LFC-së, i cili tashmë nuk ofron shërbim balancues për OST-në dhe i cili, me kërkesën e OST-së, do të bëjë të disponueshme të gjithë fuqinë e tij aktive, në përputhje me kufizimet e tij teknike; dhe

61. OST të tjera që janë në gjendje normale ose alarmi.

2. Një OST mund të aktivizojë mbështetjen për energji aktive nga një ofrues i shërbimit balancues ose një SGU, sipas pikave "a" dhe "b", të paragrafit 1, vetëm nëse ai ka aktivizuar të gjitha ofertat e energjisë balancuese në dispozicion, duke marrë parasysh kapacitetin ndërzonal në dispozicion në momentin e mungesës së mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit.

3. Çdo OST e cili ka qenë subjekt i një kërkese për suport për fuqi aktive sipas paragrafit 1 (c), duhet të:

a) vendosë në dispozicion ofertat e tij të pashpërndara;

62. ketë të drejtën të aktivizojnë energjinë balancuese në dispozicion, në mënyrë që të sigurojë fuqinë korresponduese të OST-së që e kërkon; dhe

63. të ketë të drejtën të kërkojë asistencë për fuqi aktive nga ofruesit e shërbimit të balancimit dhe nga çdo SGU i lidhur në zonën e tij të LFC-së, i cili nuk ofron shërbim balancues për OST-në, me qëllim që të sigurojë asistencën përkatëse për fuqinë aktive tek OST-ja që e kërkon.

4. Kur aktivizon fuqinë aktive të kërkuar sipas paragrafit 1 (c), OST-ja kërkuese dhe marrëse do të kenë të drejtë të përdorin:

a) kapacitetin ndërzonal në dispozicion, në rast se aktivizimi bëhet përpara kohës së mbylljes së portës ndërzonale brenda ditës dhe nëse sigurimi i kapaciteteve ndërzonale në fjalë nuk është pezulluar sipas nenit 35;

64. kapacitetin shtesë që mund të jetë i disponueshëm për shkak të statusit në kohë reale të sistemit, në secilin rast OST-të kërkuese dhe OST-të që i kërkohet duhet të koordinojnë me OST-të e tjera të prekura në mënyrë të ndjeshme në përputhje me nenin 6 (5).

5. Pasi OST-të kërkuese dhe atyre që iu kërkohet kanë rënë dakord mbi kushtet për dhënien e suportit për energji aktive, sasia e rënë dakord e fuqisë aktive dhe kohëzgjatja e ofrimit duhet të jenë të qëndrueshme, përveç nëse sistemi i transmetimit të OST-së që siguron suportin hyn në gjendje emergjence ose *blackout*-i.

Neni 22

Procedura e shkyçjes manuale të kërkesës

1. Përveç masave të përcaktuara në nenet 18 deri në 21, secila OST mund të përcaktojë një sasi të kërkesës neto për t'u shkëputur manualisht, direkt nga OST-ja ose në mënyrë të indirekte nëpërmjet OSSh-ve, kur nevojitet për të parandaluar përhapjen ose përkeqësimin e gjendjes së emergjencës. Kur kërkesa duhet të shkyçet drejtpërdrejt, OST-ja do të informojë pa vonesë OSSh-të respektive.

2. OST-ja do të aktivizojë shkyçjen manuale të kërkesës neto të përmendur në paragrafin 1, për:

a) të zgjidhur mbingarkesat ose situatat në nëntension; ose

b) të zgjidhur situatat në të cilat është kërkuar suport për fuqinë aktive sipas nenit 21, por që nuk është e mjaftueshme për ruajtjen e mjaftueshmërisë për periudhat kohore të ditës në avancë dhe brenda ditës në zonën e saj të kontrollit, në përputhje me nenin 107 të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC, duke çuar në rrezik të përkeqësimit të frekuencës në zonën sinkrone.

3. OST-ja do të njoftojë OSSh-të për sasinë e kërkesës neto të caktuar për t'u shkëputur në sistemet e tyre të shpërndarjes sipas paragrafit 1. Secila OSSh do të shkyçë shumën e njoftuar të kërkesës neto, pa vonesë të panevojshme.

4. Brenda 30 ditëve nga incidenti, OST-ja do të përgatisë një raport që përmban një shpjegim të detajuar të arsyetimit, zbatimit dhe ndikimit të këtij veprimi dhe t'ia dorëzojë atë autoritetit përkatës rregullator, në përputhje me nenin 59 të Direktivës BE 2019/944, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2021/13/MC-EnC.

KAPITULLI III
PLANI I RIVENDOSJES

SEKSIONI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 23
Hartimi i planit të rivendosjes

1. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo OST do të hartojë një plan rivendosjeje në konsultim me OSSh-në respektive, SGU-të, autoritetet rregullatore kombëtare ose entitetet e përmendura në nenin 4 (3), OST-të fqinje dhe OST-të e tjera në atë zonë sinkrone.

2. Gjatë hartimit të planit të rivendosjes, secila OST duhet të marrë parasysh, të paktën, elementet e mëposhtme:

a) sjelljen dhe aftësinë e ngarkesës dhe gjenerimit;

65. nevojat specifike të SGU-ve me prioritet të lartë, të renditur në përputhje me paragrafin 4; dhe

66. karakteristikat e rrjetit të tij dhe rrjetave kryesore të OSSh-ve.

3. Plani i rivendosjes duhet të përmbajë të paktën dispozitat e mëposhtme:

a) kushtet nën të cilat aktivizohet plani i rivendosjes, siç parashikohet në nenin 25;

67. udhëzimet e planit të rivendosjes që do të lëshohen nga OST-të; dhe

68. masat që i nënshtrohen konsultimit në kohë reale ose koordinimit me palët e identifikuara.

4. Në veçanti, plani i rivendosjes duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

a) një listë të masave që do të zbatohen nga OST-ja për instalimet e tij;

69. një listë të masave që do të zbatohen nga OSSh-ja dhe OSSh-të përgjegjëse për zbatimin e këtyre masave në instalimet e tyre;

70. një listë e SGU-ve përgjegjëse për zbatimin në instalimet e tyre të masave që rezultojnë nga kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në Rregulloret (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, (BE) 2016/1388 të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë

2018/05/PHLG-EnC dhe (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC ose nga legjislacioni kombëtar dhe një listë të masave që do të zbatohen nga këto SGU;

71. listën e përdoruesve të rrjetit me prioritet të lartë, si dhe termat dhe kushtet për shkyçjen dhe rienergjizimin e tyre;

72. një listë të nënstacioneve të cilat janë thelbësore për procedurat e planit të rivendosjes;

73. numri i burimeve të energjisë në zonën e kontrollit të OST-së të nevojshme për të rienergjizuar sistemin e tij me strategjinë nga poshtë–lart me aftësinë për *black start*, aftësi të risinkronizimit të shpejtë (nëpërmjet operimit *house load*) dhe aftësisë së operimit në ishull; dhe

74. afatet e zbatimit për secilën masë të listuar.

5. Plani i rivendosjes duhet të përfshijë të paktën masat e mëposhtme teknike dhe organizative të specifikuara në kapitullin III:

a) procedurën e rienergjizimit, në përputhje me seksionin 2;

75. procedurën e menaxhimit të frekuencës, në përputhje me seksionin 3; dhe

76. procedurën e risinkronizimit, në përputhje me seksionin 4; dhe

6. Masat e planit të rivendosjes duhet të jenë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) ndikimi në përdoruesit e sistemit të jetë minimal;

77. masat të jenë eficiente ekonomikisht;

78. të aktivizohen vetëm masat e nevojshme;

79. nuk duhet të çojnë sistemin e transmetimit të interkonektuar në gjendje emergjence ose *blackout*-i.

Neni 24

Implementimi i planit të rivendosjes

1. Secila OST do të implementojë ato masa të planit të rivendosjes që do të zbatohen në sistemin e transmetimit brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje. Që nga ai moment, ai do të mbajë masat e zbatuara nga ky afat e në vijim.

2. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, secila OST do të njoftojë OSSh-të e lidhura në transmetim mbi masat të cilat do të zbatohen, duke përfshirë afatet për zbatimin, për:

a) instalimet e OSSH-së sipas nenit 23 (4); dhe

80. instalimet e SGU-ve të identifikuara në përputhje me nenin 23 (4) dhe të lidhura me sistemet e tyre të shpërndarjes;

81. instalimet e ofruesve të shërbimit të rivendosjes të lidhur me sistemet e tyre të shpërndarjes; dhe

82. instalimet e OSSh-ve të lidhura me sistemet e tyre të shpërndarjes

3. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, secila OST do të njoftojë SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 23 (4) dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes të lidhur drejtpërdrejt me sistemin e transmetimit mbi masat që do të zbatohen në instalimet e tyre, duke përfshirë afatet për zbatim sipas pikës “g”, të nenit 23 (4).

4. Sipas parashikimeve në legjislacionin kombëtar, OST-ja do të njoftojë direkt SGU-të e identifikuara në pajtim me nenin 23 (4), ofruesit e shërbimit të rivendosjes, OSSh-të e lidhura me sistemet e shpërndarjes, dhe do të njoftojnë OSSh-në respektive për njoftimin e tyre.

5. Kur në përputhje me paragrafin 2, OST-ja njofton OSSh-në, OSSh-ja do të njoftojë menjëherë pa vonesë, SGU-të, ofruesit e shërbimit të rivendosjes dhe OSSH-të e lidhura në sistemin e saj të shpërndarjes së masave të planit të rivendosjes, të cilat ata duhet të zbatojnë në

instalimet e tyre respektive, duke përfshirë afatet për zbatim, në përputhje me pikën “g”, të nenit 23 (4).

6. Secila OSSh, SGU-të dhe ofruesi i shërbimit të rivendosjes i njoftuar, duhet:

a) të zbatojë masat e njoftuara jo më vonë së 12 muaj nga data e njoftimit;

83. të konfirmojë zbatimin e masave tek operatori i sistemit i cili, kur është i ndryshëm nga OST-ja, e njofton OST-në; dhe

84. të mbajë masat e zbatuara në instalimet e saj.

Neni 25

Aktivizimi i planit të rivendosjes

1. Çdo OST do të aktivizojë procedurat e planit të tij të rivendosjes në koordinim me OSSh-të dhe SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 23 (4), si dhe me ofruesit e shërbimit të rivendosjes, si më poshtë:

a) kur sistemi është në gjendje emergjence, në përputhje me kriteret e nenit 18 (3) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC, menjëherë pas stabilizimit të sistemit pas aktivizimit të masave të planit të mbrojtjes; ose

85. kur sistemi është në gjendje *blackout*-i, në përputhje me kriteret e nenit 18 (4) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC.

2. Gjatë rivendosjes të sistemit, secila OST do të identifikojë dhe monitorojë:

a) shkallën dhe kufijtë e rajonit të sinkronizuar ose rajoneve të sinkronizuara të cilave iu përket zona e saj e kontrollit;

86. OST-të me të cilat ai ndan një rajon të sinkronizuar ose rajone të sinkronizuara; dhe

87. rezervat e disponueshme të energjisë aktive në zonën e saj të kontrollit.

3. Çdo OSSh dhe SGU e identifikuar sipas nenit 23 (4), si dhe çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes duhet të zbatojë pa vonesë të panevojshme udhëzimet e planit të rivendosjes të lëshuara nga OST-ja, në përputhje me pikën “b”, të nenit 23 (3), me procedurat e planit të rivendosjes.

4. Çdo OST do të aktivizojë ato procedura të planit të tij të rivendosjes që kanë një ndikim të konsiderueshëm ndërkufitar në koordinim me OST-të e prekura.

SEKSIONI 2
RIENERGJIZIMI

Neni 26

Procedura e rienergjizimit

1. Procedura e rienergjizimit të planit të rivendosjes duhet të përmbajë një sërë masash që i lejojnë OST-së të zbatojë:

a) një strategji rivendosjeje nga lart–poshtë; dhe

88. një strategji rivendosjeje nga poshtë–lart.

2. Lidhur me strategjinë e rienergjizimit nga poshtë–lart, procedura e rienergjizimit duhet të përmbajë të paktën masat, për:

a) menaxhimin e devijimeve të tensionit dhe frekuencës për shkak të rienergjizimit;

89. monitorimin dhe menaxhimin e operimit në ishull; dhe
90. risinkronizimi i zonave të operimit në ishull.

Neni 27
Aktivizimi i procedurës së rienergjizimit

1. Kur aktivizon procedurën e rienergjizimit, çdo OST do të përcaktojë strategjinë që do të zbatojë, duke marrë parasysh:

a) disponueshmërinë e burimeve të energjisë në zonën e saj të kontrollit që janë në gjendje të rienergjizojnë;

91. kohëzgjatjen e pritshme dhe riskun e mundshëm të strategjive të rienergjizimit;
92. kushtet e sistemeve energjetike;
93. kushtet e sistemeve të lidhura direkt, duke përfshirë së paku statusin e interkonektorëve;
94. SGU-të me prioritet të lartë, të renditur sipas nenit 23 (4); dhe
95. mundësinë për të kombinuar strategjitë e energjizimit nga lart–poshtë dhe nga poshtë–lart.

2. Kur zbatohet një strategji e rienergjizimit nga lart–poshtë, secila OST do të menaxhojë lidhjen e ngarkesës dhe gjenerimit, me qëllim që të rregullojë frekuencën drejt frekuencës nominale me një tolerancë maksimale të devijimit maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme. Secila OST do të zbatojë kushtet për lidhjen e ngarkesës dhe gjenerimit të përcaktuar nga lideri i frekuencës, kur emërohet në përputhje me nenin 29.

3. Kur zbatohet një strategji e rienergjizimit nga poshtë–lart, secila OST do të menaxhojë lidhjen e ngarkesës dhe gjenerimit me synimin e rregullimit të frekuencës drejt frekuencës së synuar, të përcaktuar në përputhje me pikën "c", të nenit 28 (3).

4. Gjatë rienergjizimit, OST-ja, pas konsultimit me OSSh-të, duhet të përcaktojë dhe njoftojë sasinë e kërkesës neto për t'u rilidhur në rrjetet e shpërndarjes. Çdo OSSh do të rilidhë sasinë e njoftuar të kërkesës neto, duke respektuar ngarkesën e bllokut dhe duke marrë parasysh rilidhjen automatike të ngarkesës dhe gjenerimit në rrjetin e saj.

5. Secila OST do të informojë OST-të e saj fqinje për aftësinë e tij për të suportuar një strategji të rienergjizimit nga lart–poshtë.

6. Për aktivizimin e një strategjie rienergjizimi nga lart–poshtë, OST-ja do të kërkojë nga OST-të fqinje të mbështesin rienergjizimin. Kjo mbështetje mund të konsistojë në suportin për fuqi aktive, në përputhje me paragrafët 3 deri në 5, të nenit 21. OST-ve që iu kërkohet do të ofrojnë suport për rienergjizim, përveç rasteve kur suporti do t'i çonte sistemet e tyre në gjendje emergjence ose *blackout*-i. Në këtë rast, OST-ja kërkuese do të përdorë strategjinë e rienergjizimit nga poshtë–lart.

SEKSIONI 3
MENAXHIMI I FREKUENCËS

Neni 28
Procedura e menaxhimit të frekuencës

1. Procedura e menaxhimit të frekuencës së planit të rivendosjes duhet të përmbajë një grup masash që synojnë rivendosjen e frekuencës së sistemit në frekuencën nominale.

2. Çdo OST do të aktivizojë procedurën e tij të menaxhimit të frekuencës:

a) në përgatitjen e procedurës së risinkronizimit, kur një zonë sinkrone është e ndarë në disa rajone të sinkronizuara;

96. në rast të devijimit të frekuencës në zonën sinkrone; ose

97. në rast të rienergjizimit.

3. Procedura e menaxhimit të frekuencave duhet të përfshijë së paku:

a) një listë veprimesh, në lidhje me parametrat e rregullatorit ngarkesë–frekuencë përpara caktimit të liderave të frekuencës;

98. emërimin e liderave të frekuencës;

99. përcaktimin e frekuencës së synuar në rastet e strategjisë së rienergjizimit nga poshtë–lart;

100. menaxhimin e frekuencës pas devijimit të frekuencës; dhe

101. menaxhimi i frekuencës pas ndarjes së zonës sinkrone;

102. përcaktimin e sasisë së ngarkesës dhe gjenerimit që do të rikyçet, duke marrë parasysh rezervat e fuqisë aktive brenda rajonit të sinkronizuar, në mënyrë që të shmangen devijime të mëdha të frekuencës.

Neni 29

Caktimi i liderit të frekuencës

1. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur një zonë sinkrone është e ndarë në disa rajone të sinkronizuara, OST-të e çdo rajoni të sinkronizuar duhet të caktojnë një lider të frekuencës, në përputhje me paragrafin 3.

2. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur zona sinkrone nuk ndahet, por frekuenca e sistemit tejkalon kufijtë e frekuencës për gjendjen e alarmit, siç përcaktohet në nenin 18 (2) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC, të gjitha OST-të e zonës sinkrone do të caktojnë një lider të frekuencës, në përputhje me paragrafin 3.

3. OST-të me K-faktorin më të lartë të vlerësuar në kohë reale do të caktohet si lider i frekuencës, përveç nëse OST-të e rajonit të sinkronizuar ose të zonës sinkrone bien dakord të caktojnë një OST tjetër si lider frekuence. Në këtë rast, OST-të e rajonit të sinkronizuar ose të zonës sinkrone, do të marrin në konsideratë kriteret e mëposhtme:

a) sasinë e rezervave aktive në dispozicion dhe veçanërisht rezervat e rivendosjes së frekuencës;

103. kapacitetet e disponueshme në dispozicion në interkonektorë;

104. disponueshmërinë e matjeve të frekuencës së OST-ve të rajonit të sinkronizuar ose të zonës sinkrone; dhe

105. disponueshmërinë e matjeve në elementet kritike brenda rajonit të sinkronizuar ose të zonës sinkrone;

4. Atje ku madhësia e zonës sinkrone në fjalë dhe gjendja në kohë reale e lejojnë, pavarësisht paragrafit 3, OST-të e zonës sinkrone mund të përcaktojnë një udhëheqës të paracaktuar të frekuencës.

5. OST-ja e caktuar si lider i frekuencës, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, do të informojë pa vonesë OST-të e tjera të zonës sinkrone për emërimin e saj.

6. Lideri i caktuar i frekuencës vepron si i tillë deri në:

a) caktimin e një udhëheqësi tjetër të frekuencës për rajonin e tij të sinkronizuar:

106. një lider i ri i frekuencës është caktuar si rezultat i risinkronizimit të rajonit të tij sinkronizuar me një rajon tjetër të sinkronizuar; ose

107. zona sinkrone është risinkronizuar plotësisht, frekuenca e sistemit është brenda diapazonit të frekuencave standarde dhe LFC-ja e operuar nga secila OST e zonës sinkrone është rikthyer në gjendjen normale të operimit të saj, në përputhje me nenin 18 (1) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC.

Neni 30

Menaxhimi i frekuencës pas devijimit të frekuencës

1. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur një lider i frekuencës është caktuar në përputhje me nenin 29 (3), OST-të e zonës sinkrone, përveç liderit të frekuencës, si masë të parë do të pezullojnë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes së frekuencës dhe rezervave zëvendësuese.

2. Pas konsultimit me OST-të e tjera të zonës sinkrone, lideri i frekuencës duhet të përcaktojë, mënyrën e funksionimit që do të zbatohet në LFC-të e operuara nga secila OST e zonës sinkrone.

3. Lideri i frekuencës do të menaxhojë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes së frekuencës dhe rezervave zëvendësuese brenda zonës sinkrone, duke synuar rregullimin e frekuencës së zonës sinkrone drejt frekuencës nominale dhe duke marrë parasysh kufijtë e sigurisë operacionale të përcaktuar në përputhje me nenin 25 të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC. Secila OST e zonës sinkrone, sipas kërkesës do të mbështesë liderin e frekuencës.

Neni 31

Menaxhimi i frekuencës pas ndarjes së zonës sinkrone

1. Gjatë rivendosjes së sistemit, kur është caktuar një lider i frekuencës sipas nenit 29 (3), OST-të e çdo rajoni të sinkronizuar, me përjashtim të liderit të frekuencës, si masë e parë do të pezullojnë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes të frekuencës dhe rezervave zëvendësuese.

2. Lideri i frekuencës duhet të përcaktojë mënyrën e operimit që do të zbatohet në LFC-të e operuara nga secila OST e rajonit të sinkronizuar, pas konsultimit me OST-të e tjera të rajonit të sinkronizuar.

3. Lideri i frekuencës duhet të menaxhojë aktivizimin manual të rezervave të rivendosjes së frekuencës dhe rezervave zëvendësuese brenda rajonit të sinkronizuar, duke synuar rregullimin e frekuencës së rajonit të sinkronizuar drejt frekuencës së synuar të përcaktuar nga lideri i risinkronizimit, nëse ka, sipas pikës “a”, të nenit 34 (1) dhe duke marrë parasysh kufijtë e sigurisë operacionale të përcaktuar në përputhje me nenin 25, të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC. Nëse nuk caktohet një lider risinkronizimi për rajonin e sinkronizuar, lideri i frekuencës do të synojë rregullimin e frekuencës drejt frekuencës nominale. Sipas kërkesës, secila OST e rajonit të sinkronizuar do të mbështesë udhëheqësin e frekuencës.

SEKSIONI 4
RISINKRONIZIMI

Neni 32

Procedura e risinkronizimit

1. Procedura e risinkronizimit tëp planit të rivendosjes duhet të përfshijë të paktën:

a) caktimin e liderit të risinkronizimit;

b) masat që lejojnë OST-në të zbatojnë strategjinë e risinkronizimit;

c) kufijtë maksimalë për këndin e fazës, ndryshimet e frekuencës dhe tensionit për linjat lidhëse.

Neni 33

Caktimi i liderit të risinkronizimit

1. Gjate rivendosjes së sistemit, kur dy rajone të sinkronizuara mund të sinkronizohen pa rrezikuar sigurinë operacionale të sistemeve të transmetimit, liderat e frekuencës së këtyre rajoneve sinkrone do të caktojnë një lider sinkronizimi në konsultim me së paku OST(të) të identifikuar si lider potencial risinkronizimi dhe në përputhje me paragrafin 2. Çdo lider i frekuencës do të informojë pa vonesë OST-të nga rajoni i tij i sinkronizuar i liderit të caktuar të risinkronizimit.

2. Për çdo palë të rajoneve sinkrone që do të risinkronizohen, lideri i risinkronizimit do të jetë OST-ja, që:

a) ka në operim së paku një nënstacion të pajisur me pajisje kyçëse paralele në kufirin ndërmjet dy rajoneve sinkrone që do të risinkronizohen;

108. ka qasje në matjet e frekuencës për të dyja rajonet sinkrone;

109. ka qasje në matjet e tensionit në nënstacionet ndërmjet të cilëve gjenden pikat potenciale të risinkronizimit; dhe

110. është në gjendje të kontrollojë tensionin e pikave potenciale të risinkronizimit.

3. Kur më shumë së një OST përmbush kriteret sipas paragrafit 2, OST-ja me numrin më të madh të pikave potenciale të risinkronizimit ndërmjet dy rajoneve të sinkronizuara do të caktohet si lider i risinkronizimit, përveç nëse liderat e frekuencës së dy rajoneve të sinkronizuara bien dakord të caktojnë një tjetër OST si lider risinkronizimi.

4. Lideri i r-sinkronizimit do të veprojë si i tillë, deri në:

a) caktimin e një lideri tjetër të risinkronizimit për dy rajonet e sinkronizuara; ose

111. janë risinkronizuar të dyja rajonet e risinkronizimit dhe janë kryer të gjitha hapat në nenin 34.

Neni 34

Strategjia e risinkronizimit

1. Para risinkronizimit, lideri i risinkronizimit duhet të:

a) përcaktojë në përputhje me kufijtë maksimalë të përmendur në nenin 32:

i. vlerën e synuar të frekuencës për risinkronizim;

ii. diferencën maksimale të frekuencës ndërmjet dy rajoneve të sinkronizuara;

iii. shkëmbimin maksimal të fuqisë aktive dhe reaktive; dhe

iv. mënyrën e operimit që do zbatohet në LFC;

112. zgjedhë pikën e risinkronizimit, duke marrë parasysh kufijtë e sigurisë operacionale në rajonet e sinkronizuara;

113. të përcaktojë dhe të përgatisë të gjitha veprimet e nevojshme për risinkronizimin e dy rajoneve të sinkronizuara në pikën e risinkronizimit;

114. të përcaktojë dhe të përgatisë grupin e veprimeve pasuese për të krijuar lidhje shtesë midis rajoneve të sinkronizuara;

115. vlerësojë gatishmërinë e rajoneve të sinkronizuara për risinkronizim, duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara në pikën "a".

2. Gjatë kryerjes së detyrave të renditura në paragrafin 1, lideri i risinkronizimit duhet të konsultohet me liderat e frekuencës së rajoneve të sinkronizuar të përfshirë dhe, për detyrat e renditura në pikat "b" deri në "e", gjithashtu, duhet të konsultohet me OST-të që operojnë në nënstacionet e përdorura për risinkronizim.

3. Çdo lider i frekuencës duhet të informojë OST-të brenda rajonit të tij të sinkronizuar të risinkronizimit të planifikuar pa vonesë të panevojshme.

4. Kur janë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 1(a), lideri i risinkronizimit do të ekzekutojë risinkronizimin, duke aktivizuar veprimet e përcaktuara në përputhje me pikat "c" dhe "d", të paragrafit 1.

KAPITULLI IV
NDËRVEPRIMET E TREGUT

Neni 35
Procedura për pezullimin e aktiviteteve të tregut

1. Një OST mundet të pezullojë përkohësisht një ose me shumë aktivitete të tregut të përcaktuara në paragrafin 2, ku:

a) sistemi i transmetimit të OST-së është në gjendje *blackout*-i; ose

116. OST-ja ka shteruar të gjitha mundësitë e ofruara nga tregu dhe vazhdimësia e aktiviteteve të tregut gjatë gjendjes së emergjencës do të përkeqësonte një ose më shumë nga kushtet e përmendura në nenin 18(3) të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC; ose

117. vazhdimësia e aktiviteteve të tregut do të zvogëlonte në mënyrë të konsiderueshme efektivitetin e procesit të rivendosjes në gjendjen normale ose në gjendjen e alarmit; ose

118. mjetet dhe pajisjet e komunikimit të nevojshme për OST-të për të lehtësuar aktivitetet e tregut nuk janë të disponueshëm.

2. Sipas paragrafit 1, mund të pezullohen aktivitetet e tregut, si më poshtë:

a) sigurimi i kapacitetit ndërzonal për alokimin e kapacitetit në kufijtë e zonave ofertuese korresponduese për secilën njësi kohë të tregut, ku pritet që sistemi i transmetimit nuk do rikthehet në gjendjen normale ose gjendjen e alarmit;

119. paraqitjen nga një ofrues i shërbimit të balancimit të ofertave të kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese;

120. sigurimin nga një palë përgjegjëse balancuese të një pozicioni të balancuar në fund të periudhës së ditës në avancë nëse kërkohet nga termat dhe kushtet lidhur me balancimin;

121. sigurimin e modifikimit të pozicionit të palëve përgjegjëse balancuese;

122. sigurimi i skedulimeve të përmendur në nenin 111(1) dhe (2), të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC; dhe

123. aktivitetet e tjera të tregut, pezullimi i të cilëve konsiderohet i nevojshëm për të ruajtur dhe/ose rivendosur sistemin.

3. Në rast të pezullimit të aktiviteteve të tregut, në përputhje me paragrafin 1, sipas kërkesës së OST-së, secili SGU duhet të operojë, kur është teknikisht e mundur, në një *set point* të fuqisë aktive të përcaktuar nga OST-ja.

4. Kur në përputhje me paragrafin 1, pezullohen aktivitetet e tregut, OST-ja mundet të pezullojë plotësisht ose pjesërisht operimin e proceseve të tij të ndikuara nga ky pezullim.

5. Kur aktivitetet e tregut pezullohen në përputhje me paragrafin 1, OST-ja duhet të koordinojë të paktën me palët, si më poshtë:

a) OST-të e rajoneve të llogaritjes së kapacitetit ku OST-ja është anëtare;

124. OST-të me të cilat OST-ja ka marrëveshje për koordinimin e balancimit;

125. NEMO-n dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, brenda zonës së tij të kontrollit;

126. OST-të e një blloku kontrolli ngarkesë–frekuencës në të cilin OST-ja është anëtar; dhe

127. llogaritësi i koordinuar i kapacitetit të rajoneve të llogaritjes së kapacitetit në të cilin OST-j është anëtaer.

6. Në rast të pezullimit të aktiviteteve të tregut, çdo OST duhet të nisë procedurën e komunikimit të përcaktuar në nenin 38.

Neni 36

Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut

1. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo OST duhet të hartojë një propozim për rregullat, në lidhje me pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut.

2. OST-ja duhet t'i publikojë këto në faqen e tij të internetit pas miratimit të tyre nga autoriteti rregullator përkatës, në përputhje me nenin 59, të Direktivës së BE 2019/944, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC.

3. Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut duhet të jenë pajtueshëm në masën e mundshme me:

a) rregullat mbi sigurimin e kapacitetit ndërzonal brenda rajoneve përkatëse të llogaritjes së kapacitetit;

128. rregullat për paraqitjen nga ofruesit e shërbimit balancues të ofertave për kapacitet balancues dhe energji balancuese nga marrëveshjet me OST-të e tjera për koordinimin e balancimit;

129. rregullat për sigurimin nga pala përgjegjëse e balancimit të një pozicioni të balancuar në fund të periudhës së ditës në avancë, nëse kërkohet nga termat dhe kushtet në lidhje me balancimin;

130. rregullat për garantimin e modifikimeve të pozicionit të palëve përgjegjëse balancuese; dhe

131. rregullat për sigurimin e skeduleve të përmendura në nenin 111(1) dhe (2), të Rregullore (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC.

4. Gjatë hartimit të rregullave për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut, çdo OST duhet të konvertojë rrethanat e përmendura në nenin 35(1) në parametra të përcaktuar objektivisht, duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

a) përqindja e shkyçjes së ngarkesës në zonën LFC të OST-së që i korrespondon:

i. paaftësisë së një pjese të rëndësishme të palëve përgjegjëse balancuese për të mbajtur balancën e tyre; ose

ii. nevojës për OST për të mos ndjekur proceset e zakonshme të balancimit për të kryer një rienergjizim eficient;

132. përqindjes së shkyçjes së gjenerimit në zonën LFC të OST-së që i korrespondon paaftësisë së një pjese të rëndësishme të palëve përgjegjëse të balancimit për të mbajtur balancën e tyre;

133. pjesa dhe shpërndarja gjeografike e elementeve të padisponueshme të sistemit të transmetimit që i korrespondon:

i. desinkronizimit të një pjese të rëndësishme të zonës LFC, duke bërë proceset e zakonshme të balancimit joproduktive; ose

ii. reduktimin në zero të kapacitetit ndërzonal në kufirin (kufijtë) e një zone ofertuese;

134. paaftësia e subjekteve të mëposhtme të prekura, në ekzekutimin e aktiviteteve të tyre të tregut për shkaqe jashtë kontrollit të tyre:

i. palët përgjegjëse balancuese;

ii. ofruesit e shërbimit të balancimit;

iii. NEMO-t dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut, në përputhje me rregulloren (BE) 2015/1222, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/PHLG-EnC;

iv. OSSh-të e lidhura në transmetim;

135. mungesa e funksionimit të duhur të mjeteve dhe pajisjeve të komunikimit, të nevojshme për të kryer:

i. bashkimin e ditës në avancë dhe brenda ditës ose çdo mekanizëm eksplicit të alokimit të kapacitetit; ose

ii. procesin e rivendosjes së frekuencës; ose

iii. procesin e zëvendësimit të frekuencës; ose

iv. sigurimin nga pala përgjegjëse balancuese të një pozicioni të balancuar në ditën në avancë dhe sigurimin e ndryshimit të pozicionit të tij; ose

v. sigurimin e skeduleve të përmendura në nenin 111(1) dhe (2), të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC.

5. Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut duhet të përcaktojnë një kohë vonese për t'u respektuar për çdo parametër të vendosur në përputhje me paragrafin 4, para nisjes së procedurës për pezullimin e aktiviteteve të tregut.

6. OST-ja në fjalë duhet të vlerësojë në kohë reale parametrat e përcaktuar në përputhje më paragrafin 4, bazuar në informacionin në dispozicion të saj.

7. Gjatë raportimit do të analizohet nëse është e nevojshme harmonizimi i rregullave për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut të hartuar nga OST-të dhe ku identifikon, sipas rastit, zonat që kërkojnë harmonizim, në përputhje me nenin 36(7) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2196, ENTSO-ja për Energjinë Elektrike, duke vepruar në përputhje me nenin 3, të aktit procedural nr. 2022/01/MC-EnC, duke e zgjeruar këtë raport për të përfshirë palët kontraktuese.

8. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo OST duhet të dorëzojë në ENTSO-E, të dhënat e kërkuara për të përgatitur dhe dorëzuar raportin në përputhje me paragrafin 7.

Neni 37

Procedura për rivendosjen e aktiviteteve të tregut

1. OST-ja në fjalë, në koordinim me NEMO (t) aktive në zonën e tij të kontrollit dhe me OST-të fqinje, duhet të nisë procedurën për rivendosjen e aktiviteteve të tregut të pezulluara në përputhje me nenin 35(1), kur:

a) situata që shkaktoi pezullimin ka përfunduar dhe nuk ka asnjë situatë tjetër të përmendur në nenin 35(1); dhe

136. subjektet e përmendura në nenin 38(2) janë informuar në kohë paraprakisht, në përputhje me nenin 38.

2. OST-ja në fjalë, në koordinim me OST-të fqinje, duhet të nisë rivendosjen e proceseve të OST-së të ndikuara nga pezullimi i aktiviteteve të tregut kur plotësohen kushtet e paragrafit 1 ose më parë, nëse është e nevojshme për rivendosjen e aktiviteteve të tregut.

3. NEMO (t) respektive, në koordinim më OST-të dhe subjektet e përmendura në nenin 35(5), duhet të nisin rivendosjen e proceseve të bashkimit të ditës në avancë dhe/ose brenda ditës sa më shpejt që OST(të) njoftojnë që proceset e OST-së janë rivendosur.

4. Kur sigurimi i kapacitetit ndërzonal është pezulluar dhe më pas rivendosur, çdo OST në fjalë duhet të përditësojë kapacitetet ndërzonale për alokimin e kapacitetit duke përdorur, mundësinë me më shume përfitim dhe eficiente për çdo njësi kohe tregu, si më poshtë:

a) duke përdorur kapacitetet ndërzonal më të fundit në dispozicion të llogaritura nga llogaritësi i koordinuar i kapacitetit;

b) duke nisur proceset e llogaritjes së kapacitetit rajonal të zbatueshme, në përputhje me nenin 29 dhe 30, të Rregullores (BE) 2015/1222, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/PHLG-EnC; ose

c) duke përcaktuar, në koordinim me OST-të e rajonit të llogaritjes së kapacitetit, kapacitetet ndërzonale bazuar në kushtet fizike aktuale të rrjetit.

5. Kur pjesë e zonës totale të bashkuar ku aktivitetet e tregut ishin pezulluar, është kthyer në gjendjen normale ose gjendjen e alarmit, NEMO (t) e kësaj zone do të kenë të drejtën të kryejnë një bashkim tregu në një pjesë të zonës totale të bashkuar, në konsultim me OST-të dhe subjektet e përmendura në benin 35(5), me kusht që OST-ja të ketë rivendosur procesin e llogaritjes së kapacitetit.

6. Jo më vonë së 30 ditë pas rivendosjes së aktiviteteve të tregut, OST(të) që kanë pezulluar dhe rivendosur aktivitetet e tregut duhet të përgatisin një raport, të paktën në anglisht, që përmban shpjegim të detajuar të arsyetimit, implementimit dhe ndikimit të pezullimit të tregut dhe një referencë për pajtueshmërinë me rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut dhe duhet ta dorëzojë atë në autoritetin rregullator përkatës, në përputhje me nenin 59 të Direktivës së BE 2019/944, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC dhe do të venë në dispozicion të subjekteve të përmendura në nenin 38(2).

7. Autoritetet rregullatore të palëve kontraktuese ose Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë mund të lëshojnë një rekomandim për OST(të) në fjalë për të promovuar praktikat e mira dhe për të parandaluar incidente të ngjashme në të ardhmen.

Neni 38

Procedura e komunikimit

1. Rregullat për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut të hartuara në përputhje me nenin 36, gjithashtu, duhet të përmbajnë një procedurë komunikimi ku detajohen detyrat dhe veprimet e pritshme nga çdo palë në rolet e tij të ndryshme gjatë pezullimit dhe rivendosjes së aktiviteteve të tregut.

2. Procedura e komunikimit duhet të sigurojë që informacioni i dërgohet, njëherësh, subjekteve të mëposhtme:

a) palëve të përmendura në nenin 35 (5);

137. palëve përgjegjëse balancuese;

138. ofruesve të shërbimit të balancimit;

139. OSSH-ve të lidhura në transmetim;

140. Autoritetit rregullator përkatës të palëve kontraktuese përkatëse, në përputhje me nenin 59, të Direktivës së BE 2019/944, të Parlamentit Evropian, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC.

3. Procedura e komunikimit duhet të përmbajë të paktën hapat e mëposhtëm:

a) njoftimin nga OST-ja që aktivitetet e tregut janë pezulluar në përputhje me nenin 35;

141. njoftimin nga OST-ja të vlerësimit më të mirë për kohën dhe datën për rivendosjen e sistemit të transmetimit;

142. njoftimin nga NEMO dhe subjektet e tjera të caktuara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, dhe Rregulloren (BE) 2016/1719, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2022/03/PHLG-EnC, mbi pezullimin e aktiviteteve të tyre, nëse ka;

143. përditësimet nga OST-të mbi procesin e rivendosjes së sistemit të transmetimit;

144. njoftimin nga subjektet e përmendura në pikat "a" deri në "d", të paragrafit 2, që mjetet e tregut dhe sistemet e tyre të komunikimit janë në operim;

145. njoftimin nga OST(të) që sistemi i transmetimit është rikthyer në gjendjen normale ose gjendjen e alarmit;

146. njoftimin nga NEMO dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/PHLG-EnC, për vlerësimin më të mirë për kohën dhe datën kur do të rivendosen aktivitetet e tregut; dhe

147. konfirmimin nga NEMO dhe subjektet e tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksionet e tregut në përputhje me Rregulloren (BE) 2015/1222, të përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/03/PHLG-EnC, që aktivitetet e tregut janë rivendosur.

4. Të gjitha njoftimet dhe përditësimet nga OST(të), NEMO(t) dhe subjekte të tjera të caktuara ose të deleguara për të kryer funksione të tregut të përmendura në paragrafin 3, duhet të publikohen në faqen e internetit të këtyre subjekteve. Kur njoftimi ose përditësimi në faqen e internetit nuk është i mundur, entiteti subjekt i detyrimit për të njoftuar, duhet të njoftojë nëpërmjet *email*-it ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të disponueshëm, të paktën ato palë që marrin pjesë direkt në aktivitetet e pezulluara të tregut.

5. Njoftimi në përputhje paragrafin 3, pika "e", do të bëhet nëpërmjet *email*-it ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të disponueshëm të OST-së përkatëse.

Neni 39

Rregullat për shlyerjet në rast të pezullimit të aktiviteteve të tregut

1. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo OST duhet të zhvillojë një propozim për rregullat për shlyerjen e disbalancave dhe shlyerjen e kapacitetit balancues dhe energjisë balancuese, të cilat duhet të zbatohen për periudhat e shlyerjes së disbalancës gjatë të cilave aktivitetet e tregut ishin pezulluar. OST-ja mund të propozojë të njëjtat rregulla që zbatohen për operimin normal.

OST-ja duhet t'i publikojë këto rregulla në faqen e tij të internetit pas miratimit të tyre nga autoriteti rregullator përkatës, në përputhje me nenin 59 të Direktivës (BE) 2019/944, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC.

Një OST mund të delegojë detyrat e OST-së, të përmendura në këtë nen, tek një ose më shumë palë të treta, me kusht që pala e tretë të mund të kryejë funksionin përkatës të paktën aq efektivisht sa OST (të). Një palë kontraktuese ose kur është e zbatueshme, një autoritet rregullator, mund të caktojë detyrat e përmendura në këtë nen te një ose më shumë palë të treta, me kusht që pala e tretë të kryejë funksionin përkatës të paktën aq efektivisht sa OST (të).

2. Rregullat e përmendura në paragrafin 1 duhet të adresojnë shlyerjet mes OST-së dhe palëve të treta, kur është e nevojshme, me palët përgjegjëse të balancimit dhe ofruesit e shërbimit të balancimit.

3. Rregullat e hartuara në përputhje me paragrafin 1, duhet të:

a) sigurojnë neutralitetin financiar të secilës OST dhe pale të tretë përkatëse, të përmendur në paragrafin 1;

148. shmangin deformimin e incentivave ose incentivat joproduktive për palët përgjegjëse balancuese, ofruesit e shërbimit të balancimit dhe OST-të;

149. nxisë palët përgjegjëse balancuese për të qenë të balancuar ose të ndihmojnë sistemin të rivendosë balancën e tij;

150. shmangë çdo penalitet financiar të imponuar mbi palët përgjegjëse të balancimit dhe ofruesit e shërbimit të balancimit për shkak të kryerjes së veprimeve të kërkuara nga OST-ja;

151. shkurajojë OST-të nga pezullimi i aktiviteteve të tregut, përveç nëse është i nevojshëm, dhe të nxisë OST-të të rivendosin aktivitetet e tregut sa më shpejt të jetë e mundur; dhe

152. të nxisë ofruesit e shërbimit balancues për të ofruar shërbime të OST-së ku janë lidhur që ndihmon rivendosjen e sistemit në gjendjen normale.

KAPITULLI V

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMI, MJETET DHE PAJISJET

Neni 40

Shkëmbimi i informacionit

1. Përveç dispozitave të neneve 40 deri 53, të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC, çdo OST, gjatë gjendjes së emergjencës, *blackout*-it apo të rivendosjes, duhet të ketë të drejtën të mbledhë informacionin e mëposhtëm:

a) nga OSSH-të e identifikuara në përputhje me nenin 23(4), informacionin e nevojshëm për të paktën:

i. pjesën e rrjetit të tyre që operon në ishull;

ii. aftësinë për të sinkronizuar pjesët e rrjetit të tyre që operojnë në ishull; dhe

iii. aftësinë për të nisur operimin në ishull;

153. nga SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 23(4) dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes, informacionin për të paktën kushtet e mëposhtme:

i. gjendjen aktuale të instalimit;

ii. kufijtë operacionalë;

iii. kohën e aktivizimit të plotë dhe kohën për rritjen e gjenerimit; dhe

iv. proceset e kohës kritike.

2. Gjatë gjendjes së emergjencës, *blackout*-it ose rivendosjes, çdo OST duhet të sigurojë në kohën e duhur dhe kur është i disponueshëm për OST, për qëllime të procedurave të planit të mbrojtjes së sistemit dhe procedurave të planit të rivendosjes, informacionin e mëposhtëm:

a) te OST-të fqinje, informacionin për të paktën:

i. shtrirjen dhe kufijtë e rajonit të sinkronizuar ose rajoneve të sinkronizuara të cilit i përket zona e tij e kontrollit;

ii. kufizimet për operimin e rajonit të sinkronizuar;

iii. kohëzgjatjen maksimale dhe sasinë e fuqisë aktive dhe reaktive që mund të furnizohet nëpërmjet intekonektorëve; dhe

iv. çdo kufizim tjetër teknik apo organizativ;

154. te lideri i frekuencës së rajonit të tij të sinkronizuar, informacionin për të paktën:

i. kufizimin për të mbajtur operimin në ishull;

ii. ngarkesën dhe gjenerimin shtesë të disponueshëm; dhe

iii. disponueshmërinë e rezervave operacionale;

155. te OSSH-të e lidhura në transmetim të identifikuara, në përputhje me nenet 11(4) dhe 23(4), informacionin për të paktën:

i. gjendjet e sistemit të tij të transmetimit;

ii. kufijtë e fuqisë aktive dhe reaktive, ngarkesën e bllokut, pozicionin e degëzimit dhe të çelësit në pikat e lidhjes;

iii. informacionin mbi statusin aktual dhe të planifikuar të moduleve gjeneruese të energjisë të lidhura në OSSH, nëse nuk janë të disponueshme direkt të OSSH-së; dhe

iv. të gjithë informacionin e nevojshëm që çon në koordinim të mëtejshëm me palët e lidhura në shpërndarje;

156. te ofruesit e shërbimit të mbrojtjes, informacionin për të paktën:

i. gjendjen e sistemit të tij të transmetimit; dhe

ii. masat e planifikuara që kërkojnë pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimit të mbrojtjes;

157. te OSSH-të dhe SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 23(4) dhe te ofruesit e shërbimit të rivendosjes, informacionin për të paktën:

i. gjendjen e sistemit të tij të transmetimit;

ii. aftësinë dhe planet për të rienergjizuar bashkimet; dhe

iii. masat e planifikuara që kërkojnë pjesëmarrjen e tyre.

3. OST-të në gjendjen e emergjencës, *blackout*-it apo rivendosjes duhet të shkëmbejnë midis tyre informacion, në lidhje me të paktën:

a) rrethanat që çuan në gjendjen aktuale të sistemit të tij të transmetimit, në masën që ato janë të njohura; dhe

158. problemet e mundshme që kërkojnë nevojën e asistencës për fuqi aktive.

4. Një OST në gjendjen e emergjencës, *blackout*-i apo rivendosjes duhet të sigurojë, në kohën e duhur, informacionin për gjendjen e sistemit të tij të transmetimit dhe nëse është e disponueshme informacion shtesë, duke shpjeguar situatën mbi sistemin e transmetimit:

a) te NEMO(t), të cilët duhet ta bëjnë këtë informacion të disponueshëm për pjesëmarrësit e tyre të tregut siç parashikohet në nenin 38;

159. te autoriteti i tij rregullator përkatës në përputhje me nenin 59, të Direktivës BE 2019/944, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC ose kur parashikohet në mënyrë eksplicite në legjislacionin kombëtar, të subjektet e përmendura në nenin 4(3); dhe

160. te çdo palë tjetër përkatëse, sipas rastit.

5. OST-të duhet të informojnë çdo palë të prekur për planin e testimit të hartuar në përputhje me nenet 43(2) dhe (3).

Neni 41

Sistemet e komunikimit

1. Çdo OSSH dhe SGU e identifikuar në përputhje me pikat "b" dhe "c", të nenit 23(4), çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes dhe çdo OST duhet të ketë një sistem komunikimi zanor me pajisjet shtesë të mjaftueshme dhe burime rezervë për furnizimin me energji, për të lejuar shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për planin e rivendosjes për të paktën 24 orë, në rast të mungesës totale të furnizimit të jashtëm me energji ose në rast të dështimit të çdo pajisjeje individuale të sistemit të komunikimit zanor. Palët kontraktuese mund të kërkojnë një kapacitet rezervë minimal më të madh së 24 orë.

2. Çdo OST duhet të hartojë, në konsultim me OSSH-të dhe SGU-të e identifikuara në përputhje me nenin 23(4) dhe me ofruesit e shërbimit të rivendosjes, kërkesat teknike që duhen plotësuar nga sistemet e tyre të komunikimit zanor njëkohësisht edhe nga sistemi vjetak i OST-së së komunikimit zanor në mënyrë që të lejohet ndërveprimi i tyre dhe të garantohet që thirrja hyrëse e OST-së të identifikohet nga pala tjetër dhe të përgjigjet menjëherë.

3. Çdo OST duhet të hartojë, në konsultim me OST-të e tij fqinje dhe OST-të e tjera të zonës së tij sinkrone, kërkesat teknike që duhen plotësuar nga sistemet e tyre të komunikimit zanor njëkohësisht edhe nga sistemi vetjak i OST-së së komunikimit zanor, në mënyrë që të lejohet ndërveprimi i tyre dhe të garantohet që thirrja hyrëse e OST-së të identifikohet nga pala tjetër dhe të përgjigjet menjëherë.

4. Pavarësisht nga paragrafi 1, ato SGU të identifikuara në përputhje me nenin 23(4) që janë module gjenerues të tipit B dhe ata ofrues të shërbimit të rivendosjes që janë module gjeneruese të tipave A ose B, duhet të kenë mundësinë të kenë vetëm një sistem komunikimi të dhënash, në vend të sistemit të komunikimit zanor, nëse dakordësohet me OST-në. Ky sistem komunikimi të dhënash duhet të plotësojë kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2.

5. Palët kontraktuese mund të kërkojnë që përveç sistemit të komunikimin zanor, të përdoret një sistem komunikimi plotësues për të mbështetur planin e rivendosjes; në këtë rast, sistemi plotësues i komunikimit duhet të përfshijë kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1.

Neni 42

Mjetet dhe pajisjet

1. Çdo OST duhet të bëjë të disponueshme mjetet dhe pajisjet kritike të përmendura në nenin 24, të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC, për të paktën 24 orë, në rastin e humbjes së furnizimit primar me energji.

2. Çdo OSSH dhe SGU e identifikuar në përputhje me nenin 23 (4) njëkohësisht edhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes duhet të bëjnë të disponueshme mjetet dhe pajisjet kritike të përmendura në nenin 24, të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC dhe të përdorura në planin e rivendosjes për të paktën 24 orë, në rast të humbjes së furnizimit primar me energji, sipas përcaktimeve nga OST-ja.

3. Çdo OST duhet të ketë të paktën një dhomë kontrolli rezervë, gjeografikisht të ndarë. Dhoma rezervë e kontrollit duhet të përfshijë të paktën mjetet dhe pajisjet kritike të përmendura në nenin 24, të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC. Çdo OST duhet të caktojë një furnizim rezervë energjie për dhomën rezervë të kontrollit për të paktën 24 orë, në rast të humbjes së furnizimit primar me energji.

4. Çdo OST duhet të përgatisë një procedurë transferimi për funksionet e lëvizjes nga dhoma kryesore e kontrollit në dhomën rezervë të kontrollit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast në kohën maksimalë prej 3 orësh. Procedura duhet të përfshijë operimin e sistemit gjatë transferimit.

5. Nënstacionet e identifikuara si themelore për procedurat e planit të rivendosjes në përputhje me nenin 23(4), duhet të jenë në operim në rast të humbjes së furnizimit primar me energji për të paktën 24 orë **<..>**.

KAPITULLI VI
PAJTUESHMËRIA DHE RISHIKIMI

SEKSIONI 1
TESTIMI I PAJTUESHMËRISË SË AFTËSIVE TË OST-ve, OSSH-ve DHE SGU-ve

Neni 43
Parimet e përgjithshme

1. Secila OST, periodikisht do të vlerësojë funksionimin e duhur të të gjitha pajisjeve dhe aftësive të marra parasysh në planin e mbrojtjes dhe rivendosjes të sistemit. Për këtë qëllim çdo OST do të verifikojë periodikisht pajtueshmërinë e tillë të pajisjeve dhe aftësive, në përputhje me paragrafin 2 dhe me nenin 41 (2), të Rregullores (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, neni 35 (2), të Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC dhe nenit 69 (1) dhe (2), të Rregullores (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC.

2. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, secila OST do të përcaktojë një plan testimi në konsultim me OSSh-të, SGU-të e identifikuara në përputhje me nenet 11 (4) dhe 23 (4), ofruesit e shërbimit të mbrojtjes dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes. Plani i testimit do të identifikojë pajisjet dhe aftësitë respektive që duhet të testohen për planin e mbrojtjes së sistemit dhe planin e rivendosjes së tij.

3. Plani i testimit duhet të përfshijë periodicitetin dhe kushtet e testeve, duke ndjekur kërkesat minimale të përshkruara në nenet nga 44 deri në 47. Plani i testimit duhet të ndjekë metodologjinë e përcaktuar në Rregulloren (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, Rregullorja (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC dhe Rregullorja (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC, për aftësinë përkatëse të testuar. Për SGU-të që nuk i nënshtrohen Rregullores (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC dhe Rregullores (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC, plani i testimit do të ndjekë dispozitat e legjislacionit kombëtar.

4. Gjatë testimit, çdo OST, OSSh, SGU, ofrues i shërbimit të mbrojtjes dhe ofrues i shërbimit të rivendosjes nuk duhet të rrezikojë sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit dhe të sistemit të ndërlidhur. Testi duhet të kryhet në mënyrën që minimizon ndikimin në përdoruesit e sistemit.

5. Testi konsiderohet i suksesshëm kur plotëson kushtet e përcaktuara nga operatori i sistemit respektiv në përputhje me paragrafin 3. Për sa kohë që një test nuk i përmbush këto kritere, OST, OSSH, SGU, ofruesi i shërbimit të mbrojtjes dhe ofruesi i shërbimit të rivendosjes do të përsërisë testin.

Neni 44

Testimi i pajtueshmërisë së aftësive të moduleve gjeneruese të energjisë

1. Secili ofrues i shërbimit të rivendosjes, i cili është një modul gjenerues i energjisë që ofron shërbimin e *black start*-it, duhet të kryejë testin e aftësisë së *black start*-it, të paktën çdo tre vjet, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 45 (5) të Rregullores (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC.

2. Secili ofrues i shërbimit të rivendosjes, i cili është një modul gjenerues i energjisë që ofron shërbimin e risinkronizimit të shpejtë, duhet të ekzekutojë testin e kalimit në gjendjen *house load* pas çdo ndryshimi të pajisjes që ndikon në aftësinë e saj *house load* të operimit ose pas dy veprimeve të pasuksesshme të njëpasnjëshme në operimin real, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 45 (6) të Rregullores (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC.

Neni 45

Testimi i pajtueshmërisë së objekteve të kërkesës që sigurojnë përgjigje të kërkesës

1. Secili ofrues i shërbimit të mbrojtjes që ofron përgjigje të kërkesës, do të ekzekutojë testin e modifikimit të kërkesës, pas dy përgjigjeve të pasuksesshme radhazi të operimit në kohë reale ose së paku çdo vit, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 41, pika 1 të Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC.

2. Secili ofrues i shërbimit të mbrojtjes që ofron përgjigje të kërkesës për shkyçjen e kërkesës në frekuencë të ulët, duhet të kryejë testin e shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët brenda një periudhe që do të përcaktohet në nivel kombëtar dhe sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin

37 (4), të Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC, për objektet e kërkesës të lidhur në transmetim ose sipas një metodologjie të ngjashme të përcaktuar nga operatori i sistemit përkatës për objektet e tjera të kërkesës.

Neni 46

Testimi i pajtueshmërisë së aftësive të HVDC-së

Secili ofrues i shërbimit të rivendosjes, i cili është një sistem HVDC-je që ofron shërbimin e *black start*-it, duhet të ekzekutojë testin e aftësisë për *black start* të paktën çdo tre vjet, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 70 (11), të Rregullores (BE) 2016/1447, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC.

Neni 47

Testimi i pajtueshmërisë i releve të shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët

Çdo OSSH dhe OST do të kryejë testimin në reletë e shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët, të zbatuar në instalimet e tyre brenda një periudhe që do të përcaktohet në nivel kombëtar dhe sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 37 (6) dhe nenin 39 (5), të Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar me vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC.

Neni 48

Testimi i sistemeve të komunikimit

1. Çdo OSSh dhe SGU e identifikuar në përputhje me nenin 23 (4), secila OST dhe secili ofrues i shërbimit të rivendosjes do të testojë sistemet e komunikimit të përcaktuara në nenin 41, të paktën çdo vit.

2. Secila OSSh dhe SGU e identifikuar në përputhje me nenin 23 (4), çdo OST dhe çdo ofrues i shërbimit të rivendosjes do të testojë furnizimin rezervë me energji të sistemeve të tyre të komunikimit të paktën çdo pesë vjet.

3. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, secila OST, në konsultim me OST-të tjera, do të përcaktojë një plan testimi për testimin e komunikimit ndër-OST.

Neni 49

Testimi i mjeteve dhe pajisjeve

1. Secila OST do të testojë aftësinë e burimeve kryesore dhe rezervë të energjisë për të furnizuar qendrat kryesore dhe rezervë të kontrollit, të parashikuara në nenin 42, të paktën çdo vit.

2. Secila OST do të testojë funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve kritike të përmendura në nenin 24, të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC, të paktën çdo tre vjet, që mbulon mjetet dhe pajisjet kryesore dhe rezervë. Aty ku këto mjetë dhe pajisje përfshijnë OSSh-të ose SGU-të, këto palë do të marrin pjesë në këtë test.

3. Secila OST do të testojë aftësinë e burimeve rezervë të energjisë për të furnizuar shërbimet kryesore të nënstacioneve të identifikuara si kryesorë për procedurat e planit të rivendosjes sipas

nenit 23 (4), të paktën çdo pesë vjet. Kur këto nënstacione janë në sistemin e shpërndarjes, testin duhet ta ekzekutojë OSSh-ja.

4. Secila OST do të testojë procedurën e transferimit për lëvizjen nga qendra kryesore e kontrollit në qendrën rezervë të kontrollit, të parashikuar në nenin 42 (4), të paktën çdo vit.

SEKSIONI 2
TESTIMI I PAJTUESHMËRISË DHE RISHIKIMI I PLANEVE TË MBROJTJES DHE RIVENDOSJES SË SISTEMIT

Neni 50
Testimi i pajtueshmërisë dhe rishikimi periodik i planit të mbrojtjes së sistemit

1. Çdo OSSh e përfshirë në implementimin e shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët në instalimet e tij, një herë në vit përditëson komunikimin e njoftimit të operatorit të sistemit të parashikuar në pikën "b", të nenit 12 (6). Ky komunikim do të përfshijë tarimet e frekuencës në të cilat fillohet shkyçja e kërkesës neto dhe përqindja e kërkesës neto të shkyçur për çdo vlerë të këtij tarimi.

2. Secila OST do të monitorojë zbatimin e duhur të shkyçjes së kërkesës në frekuencë të ulët, në bazë të komunikimit vjetor me shkrim, të përmendur në paragrafin 1 dhe në bazë të detajeve të implementimit në instalimet e OST-ve kur zbatohet.

3. Çdo OST do të rishikojë, të paktën çdo pesë vjet, planin e tij të plotë të mbrojtjes së sistemit për të vlerësuar efektivitetin e tij. OST-ja në këtë rishikim duhet të marrë parasysh të paktën:

a) zhvillimin dhe evoluimin e rrjetit të tij që nga rishikimi i fundit ose dizajni i parë;

161. aftësitë e pajisjeve të reja të instaluara në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes që nga rishikimi i fundit ose dizajni i parë;

162. SGU-të e komisionuar që nga rishikimi i fundit ose dizajni i parë, aftësitë e tyre dhe shërbimet respektive të ofruara;

163. testet e kryera dhe analizat e incidenteve të sistemit, në përputhje me nenin 56 (5), të Rregullores (BE) 2017/1485, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror nr. 2022/03/MC-EnC; dhe

164. të dhënat operative të grumbulluara gjatë operimit normal dhe pas çrregullimit në sistem.

4. Çdo OST duhet të rishikojë masat përkatëse të planit të mbrojtjes së sistemit, në përputhje me paragrafin 3 përpara çdo ndryshimi thelbësor në konfigurimin e rrjetit.

5. Kur OST identifikon nevojën për të përshtatur planin e mbrojtjes së sistemit, ai ndryshon planin e mbrojtjes së sistemit dhe i zbaton këto ndryshime në përputhje me pikat "c" dhe "d", të nenit 4 (2) dhe nenet 11, dhe 12.

Neni 51
Testimi i pajtueshmërisë dhe rishikimi periodik i planit të rivendosjes

1. Çdo OST do të rishikojë masat e planit të tij të rivendosjes, duke përdorur testet të simulimit kompjuterik, duke përdorur të dhëna nga OSSh-të e identifikuar sipas nenit 23 (4) dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes, të paktën çdo pesë vjet. OST-ja do t'i përcaktojë këto teste simulimi në një procedure testimi dedikuar që mbulon së paku:

a) rruga e energjizimit e rivendosjes nga ofruesit e shërbimit të rivendosjes me aftësi për black start ose operim ishull;

b) furnizimin e shërbimeve ndihmëse kryesore të moduleve gjeneruese;

c) procesi i rikyçjes së kërkesës; dhe

d) procesi i risinkronizimit të rrjeteve në operim në ishull.

2. Përveç kësaj, kur nga OST-ja konsiderohet e nevojshme për efektivitetin e planit të rivendosjes, secila OST do të kryejë testimin operacional të pjesëve të planit të rivendosjes, në koordinim me OSSh-të e identifikuar sipas nenit 23 (4) dhe ofruesit e shërbimit të rivendosjes. Në konsultim me OSSh-të dhe ofruesit e shërbimeve të rivendosjes, OST-ja do të përcaktojë një procedurë testimi të dedikuar për këto teste operacionale.

3. Të paktën çdo pesë vjet, çdo OST do të rishikojë planin e tij të rivendosjes për të vlerësuar efektivitetin e tij.

4. Çdo OST do të rishikojë masat përkatëse të planit të tij të rivendosjes, në përputhje me paragrafin 1 dhe do të rishikojë efektivitetin e tyre përpara çdo ndryshimi thelbësor në konfigurimin e rrjetit.

5. Kur OST-ja identifikon nevojën për të përshtatur planin e rivendosjes, ai ndryshon planin e rivendosjes dhe i zbaton këto ndryshime në përputhje me pikat “c” dhe “d”, të nenit 4 (2) dhe neneve 23 dhe 24.

KAPITULLI VII
IMPLEMENTIMI

Neni 52
Monitorimi

1. ENTSO për Energjinë Elektrike, duke vepruar në përputhje me nenin 3 të aktit procedural nr. 2022/02/MC-EnC, do të monitorojë zbatimin e kësaj rregulloreje në çështjet e mbuluara nga ky paragraf. Në këtë kuptim të monitorimit që mbulon palët kontraktuese që gjenden jashtë zonës sinkrone të Evropës Kontinentale ose që nuk janë pjesë e ENTSO-E, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të mbledhë të dhëna nga operatorët respektivë të transmetimit**.** Monitorimi nga ENTSO-E do të mbulojë në veçanti çështjet e mëposhtme:

a) identifikimin në zbatimin kombëtar të çdo divergjence për artikujt e listuar në nenin 4 (2) të kësaj rregulloreje;

b) vlerësimi i qëndrueshmërisë së planit të mbrojtjes dhe planit të rivendosjes së sistemit të kryera nga OST-të, në përputhje me nenin 6;

c) pragjet mbi të cilat ndikimi i veprimeve të një ose më shumë OST-ve në gjendjet e emergjencës, ndërprerjes ose rivendosjes konsiderohet i rëndësishëm për OST-të e tjera brenda rajonit të llogaritjes së kapacitetit, në përputhje me nenin 6;

d) nivelin e harmonizimit të rregullave për pezullimin dhe rivendosjen e aktiviteteve të tregut të përcaktuara nga OST-të në përputhje me nenin 36 (1) dhe për qëllimet e raportit të parashikuara në nenin 36 (7);

e) nivelin e harmonizimit të rregullave për shlyerjen e disbalancave dhe energjisë balancuese në rastet e pezullimit të tregut, të përmendur në nenin 39.

2. <..>

3. OST-të respektive do t’i dorëzojnë ENTSO-E informacionin e kërkuar për kryerjen e detyrave të përmendura në paragrafin 1.

4. Pas një kërkese të autoritetit rregullator përkatës në përputhje me nenin 59, të Direktivës BE 2019/944, të përshtatur dhe miratuar nga vendimi i Këshillit Ministror 2021/13/MC-EnC, OSSh-të dhe subjektet sipas nenit 39 (1) i ofrojnë OST-ve informacionin sipas nenit 52, paragrafi 2, të Rregullores 2017/2196, përveç nëse ato informacione tashmë janë në dispozicion të autoritetit rregullator, OST-ve, Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose ENTSO-E, në lidhje me detyrat e tyre monitoruese të implementimit, me qëllim shmangien e dublikimit të informacionit.

Neni 53
Përfshirja e grupeve të interesit

Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim të ngushtë me ENTSO-E, do të organizojë përfshirjen e palëve të interesit, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje. Një përfshirje e tillë do të përfshijë takime të rregullta me palët e interesit për të identifikuar problemet dhe për të propozuar përmirësime në lidhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

KAPITULLI VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 54
Ndryshimet në kontratat dhe termat, dhe kushtet e përgjithshme

Të gjitha klauzolat përkatëse në kontratat dhe termat dhe kushtet e përgjithshme të OST-ve, OSSh-ve dhe SGU-ve, në lidhje me operimin e sistemit, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. Për këtë qëllim, këto kontrata, terma dhe kushte të përgjithshme do të modifikohen në përputhje me rrethanat.

Neni 55
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Enti Rregullator i Energjisë.

ANEKS

Karakteristikat e skemës së shkyçjes automatike të kërkesës në frekuencë të ulët:

Parametri	Vlerat e ZS e Evropës Kontinentale	<.>	<.>	Njësia matëse
Niveli fillestar i shkyçjes së detyrueshme: Frekuenca.	49	<.>	<.>	Hz.
Niveli i fillimit të shkyçjes së detyrueshme: Kërkesa për t'u shkyçur.	5	<.>	<.>	% e ngarkesës totale në nivel nacional.
Niveli i final i shkyçjes së detyrueshme: Frekuenca.	48	<.>	<.>	Hz.
Niveli i final i shkyçjes së detyrueshme: Kërkesa kumulative për t'u shkyçur; Frekuenca.	45	<.>	<.>	% e ngarkesës totale në nivel kombëtar.
Shkallët e implementimit	± 7	<.>	<.>	% e ngarkesës totale në nivel nacional për një frekuencë të dhënë.
Numri minimal i hapave për arritjen e nivelit final të detyrueshëm.	6	<.>	<.>	Numri i hapave.
Maksimumi i kërkesës së shkyçur për secilin hap.	10	<.>	<.>	% e ngarkesës totale në nivel nacional për një hap të dhënë.